



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Drejtoria e Policisë së Shtetit  
Drejtoria e Përgjithshme për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda  
Drejtoria për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafikeve

Bulevardi "Bajram CURRI"

Tel. 00355 42 255 612 Fax. 00355 42 367 086

Relacion

Në funksion të procedimit penal nr. 81 viti 2015

Në Tiranë sot më datë 24.06.2016.

Unë Gjergji OSHAFI, Oficer i Policisë Gjyqësore, në Sektorin për Hetimin e Narkotikëve, në Drejtorinë për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafikeve, bazuar në kërkesat e Kodit të Procedurës Penale, paraqes këtë relacion me shkrim në funksion të procedimit penal nr. 81 viti 2015 të Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë, për veprën penale të "Trafikimit të lëndëve narkotike" e kryer në bashkëpunim, e parashikuar në nenin 283/a/2 të Kodit Penal. Nga studimi i materialeve proceduriale;

K O N S T A T O V A

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë më datë ka regjistruar procedimin penal Nr. 81, në ngarkim të shtetasve Jurgen Molla e Orges Myftaraj, mbi dyshimet se po kryenin veprën penale të "Trafikimit të narkotikeve" në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 283/a/2 të K.Penal, në bazë të materialeve të referuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Nga studimi i materialeve të referuara si dhe hetimet e kryera gjatë kësaj periudhe, ka rezultuar se shtetasi Jurgen Molla, Orges Myftaraj, Klaudio Veizaj dhe Arif Çiço; në bashkëpunim edhe me shtetas të tjerë shqiptarë, kosovarë dhe turq me banim në Shqipëri, Kosovë, Turqi, etj, kishin ngritur një linjë trafikimi të lëndës narkotike të llojit "Heroinë", e cila vinte nga Turqia në Kosovë dhe nga aty në Shqipëri. Këtu, kjo lëndë narkotike shpërndahej sipas kërkesave dhe dërgohej nëpërmjet eksportit drejt vendeve europiane.

SEKRET

Bazuar në raportet e shërbimit dhe procesverbaleve për përgjimin e Telekomunikimeve dërguar pranë Prokurorisë për Krime Të Rënda me shkresë numër 137 prot. Datë 15.02.2016 dhe nr. 540 prot. datë 03.06.2016 rezulton si vijon:

Gjatë muajit Mars dhe prill shtetasi Jurgen Molla është takuar në mënyrë të vazhdueshme dhe ka komunikuar në telefon me shtetasin kosovar Arif Çiço. Takimet dhe komunikimet janë bërë në funksion të trafikimit të lëndëve narkotike nga Kosova në Shqipëri dhe më pas në Greqi. Konkretisht më datat 19.03.2015, 28.03.2015 etj, shtetasi Arif Çiço ka komunikuar me shtetasin Jurgen Molla dhe janë takuar disa herë sëbashku. Ndërkohë më datë 03.04.2015 shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 00355699809106 i dërgon shtetasit Arif Çiço në numrin e telefonit 00355665364624 në orën 10:56:53 mesazh me tekst, "Gjes q ka diqka" dhe në orën 11:20:40 mesazh me tekst, 'alo q ka naj zhvillim dak". Në orën 13:19:46 Jurgeni ose siç i thërrasin ndryshe Miri me numrin e telefonit 00355699809106 i telefonon shtetasit Arif Çiço në numrin e telefonit 00355665364624 dhe e pyet, "he more", Arifi i thotë se, "o çka je tu bo?" dhe, "... a je afer diku", ndërsa Miri i përgjigjet se "Alo o s'jama afer shife telefonin dhe me thuji se " dhe Arifi i thotë se, "si te vishe po pijme kafe si je afer, kurse Jrgeni i thotë se, " po shkruaji o burre a e ke vshtire a si". Me pas ne oren 13:34:41 Miri i dërgon nje mesazh me tekst, "Si jap dum se q je tu ba o shok mersh me shtat qin vet i qon i bjen ato me uj spunojn meru vesht q ka saktesisht se kam hallet e mia boll o vlla sqaro". Në orën 13:34:49 Miri i dërgon nje mesazh tjeter me tekst, "ju mir kthjelloju i her e me trego ma von q bahet se skena q tak kot se e di si jan gjanat". Në orën 19:59:40 Miri i dërgon Arifit një mesazh me tekst, 'neser a e sig qe vin te ti", më pas në orën 20:01:31 i dërgon një mesazh me tekst, "tak ne mjes pra nesër".


Më datë 04.04.2015 Arifi komunikon serish me Mirin dhe e lene te takohen. Nga studimi i raportit të shërbimit të datës 04.04.2015 rezulton se shtetasi Arif Çiço është takuar me shtetasin Jurgen Molla dhe 4 shtetas të tjerë në vendin e quajtur rruga, "Teodor Keko" në zonën e Unazës së Re, përpara Alfa Bank. Shtetasi Arif ÇIÇO erdhi në këtë takim me mjetin Mercedes Benz me ngjyrë gri me targa AA565FA, ndërsa shtetasi Jurgen Molla ishte me mjetin Audi me ngjyrë të bardhë me targa AA017LE.

Nga studimi i raporteve të shërbimit të datës 11.04.2015 rezulton se shtetasi Jurgen Molla ka qënë i ulur në ambientet e jashtme të një lokali në rrugën "Muzakët" në afërsi të një kompleksi pallatesh në zonën e Don Boskos".

Ky shtetas ka qënë sëbashku me dy shtetas të tjerë dhe pasi kanë qëndruar për pak kohë tek ky lokal janë ngritur nga tavolina, janë afruar dhe kanë hipur në autojmetin me targa AA400KD, që ndodhej i parkuar afër lokalit.

Nga studimi i raportit të shërbimit të datës 16.04.2015 rezulton që shtetasi i cili thërri tej "Nesti" u konstatua në afërsi të sheshit "Shqiponja" në autojmetin me targa AA22HS, i cili është në pronësi të shtetasit Anest Ali Koromani. Ky shtetas u takua me një shtetase fëmër rreth 30 vjeç, me flokë të gjata të zeza, veshur me xhup me ngjyrë kaf, bluzë të bardhë, pantallona xhins e cila zbriti nga Autobuzi i linjës Athinë Tiranë.

Nga studimi i transkripteve të përgjimit rezulton se më datë 29.04.2015 në orën 14:56:36 shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 00355699921623 i ka dërguar mesazh shtetasit që dyshohet të jetë Anest Ali Koromani në numrin grek të telefonit 00306942959221 me tekst "O Vlla num ja llash per gjdo gje me shkruaj ketu". Në orën 18:04:48 shtetasi Arif Çiço, i dërgon mesazh shtetasit Jurgen Molla në numrin e telefonit 00355699921623 me tekst "Num jem jam tu hik me taku mem", Jurgeni i përgjigjet me mesazh me tekst "ok". Në orën 18:37:56 shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 00355699921623 i ka dërguar mesazh shtetasit që dyshohet të jetë Anest Ali Koromani në numrin grek të telefonit 00306942959221 me tekst "u lidhet vlla", në orën 22:59:39 shtetasi që dyshohet të jetë Anest Koromani i kthen përgjigje me mesazh me tekst "o vdha nesor do ta coj ta shikojne me thuaj sa e ka gjoben ta di". Në orën 23:01:22 shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 00355699921623 i ka dërguar mesazh shtetasit që dyshohet të jetë Anest Ali Koromani në numrin grek të telefonit 00306942959221 me tekst "o vlla po qe ne rreg 17 na e le aty ku je e bera qe te ndreqim ato e te bejm naj gje vet si thu ti po beri". Në orën 23:03:15 shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 00355699921623 i ka dërguar mesazh shtetasit që dyshohet të jetë Anest Ali Koromani në numrin grek të telefonit 00306942959221 me tekst "Ky qe e ka thot ok ti shikoje vet nesor e me treg un per vete s' du gje veq te marin frym te pakten te lirohena". Në orën 23:05:00 shtetasi i cili dyshohet të jetë Anesti Koromani i kthen përgjigje me mesazh me tekst "T'ja u çoj nesor e te theme vdha", me pas në orën 23:17:15 shtetasi i cili dyshohet të jetë Anesti Koromani i dërgon një mesazh tjetër me tekst "Mire Vdha do vi une nesor o pasneser e takohemi". Në orën 23:19:06 shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 00355699921623 i ka dërguar mesazh shtetasit që dyshohet të jetë Anest Ali Koromani në numrin grek të telefonit 00306942959221 me tekst "Po mir po



sa je aty maroje at pun e eja po ben". Më datë 01.05.2015 shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 00355699921623 i ka dërguar mesazh shtetasit që dyshohet të jetë Anest Ali Koromani në numrin grek të telefonit 00306942959221 me tekst ,“ Si te kam vlla qar po ben kur je ketej”, shtetasi i cili dyshohet të jetë Anesti Koromani në orën 18:22:09 i kthen përgjigje Jurgenit me mesazh me tekst ,“ Po per dy dite theme po merem me keta legenat flasim nga afer”, më pas në orën 18:24:34 shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 00355699921623 i dërgon mesazh shtetasit që dyshohet të jetë Anest Ali Koromani në numrin grek të telefonit 00306942959221 me tekst ,“ e mir vlla po at qe pe sbejm dot gje sreg gje te flas prap un me ke ti ul naj pik qe te benim dicka me ato apo sta mor mendja fare”. Në orën 18:27:36 shtetasi i cili dyshohet të jetë Anesti Koromani në orën 18:27:36 i kthen përgjigje Jurgenit me mesazh me tekst ,“ O vdha eshte zhavor une dua me shume se ty, po nuk ju bene e do fundosem me keq te theme na afer”. Me pas në orën 18:28:37 shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 00355699921623 i ka dërguar mesazh shtetasit që dyshohet të jetë Anest Ali Koromani në numrin grek të telefonit 00306942959221 me tekst ,“ jo, jo per shtu na jena. Perdreq vet nejse tak te henen”.

Nga studimi i transkripteve të përgjimit të datave 01.05.2015 dhe 02.05.2015 rezulton se shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 00355699921623 ka komunikuar me telefon dhe me mesazhe me shtetasin Arif Çiço i cili përdor numrin e telefonit 0038649522268, ku sipas këtyre transkripteve Jurgeni në mënyrë të vazhdueshme i ka kërkuar Arifit nëse është duke bërë gjë.

Nga studimi i transkripteve të përgjimit të datave 09.05.2015 dhe 10.05.2015 rezulton se shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 00355699921623 ka komunikuar me telefon dhe me mesazhe me shtetasin Arif Çiço i cili përdor numrin e telefonit 0038649311825 ku sipas këtyre transkripteve Jurgeni në mënyrë të vazhdueshme i ka kërkuar Arifit nëse ka diçka konkrete. Më datë 10.05.2015 në orën 11:11:21 Arifi i dërgon mesazh Jurgenit me tekst ,“ sha vet anej sa u ktheva po ta shof si do e mar tu kthy te knej me nalen shum pyetje”, ndërkohë që në orën 11:13:34 Jurgeni i dërgon mesazh me tekst ,“ Po normal ok po ne qose kan ardh ec ktej e te nisim Robin nga ketu te maroj pun mos te bajm lojna kot vlla dhe del nga ktej ti jo anej nga ke dal”. Në orën 11:15:28 Arifi i dërgon mesazh Jurgenit me tekst ,“ Ok veq tem lamrojn kur bohet ne vend”.

Nga studimi i transkripteve të përgjimit të datave 11.05.2015 rezulton se shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 00355699921623 ka komunikuar me


telefon dhe me mesazhe me shtetasin Arif Çiço i cili përdor numrin e telefonit 0038649311825 ku sipas këtyre transkripteve Arifi në orën 14:38:42 me tekst „Mir shoq jam rug tu ardh te ti“. Në orën 14:39:38 Jurgeni i kthen përgjigje duke i dërguar mesazh me tekst „Po mir pra qoft per mir“ dhe e lenë të takohen te puna e Jurgenit.

Nga studimi i raportit të shërbimit të datës 11.05.2015 rezulton se shtetasi Arif Çiço është konstatuar tek vendi i quajtur „Sheshi Shqiponja“, në një automjet të markës Ęolsvagen Bittell, ngjyrë të zezë me targa 06-919AB. Automjeti ka ecur në drejtim të Kamzës, në Bulevarin Blu është kthyer djathtas në drejtim të Bathores. Autojmeti ka ndaluar në rrugën „Demokracia“ përpara kafe „Bytyçi“ dhe shtetasi Arif Çiço është takuar me një shtetas i cili thërritej Pellumb me të cilin është ulur në kafe. Në orën 19:05 në këtë vend ka ardhur dhe një shtetas tjetër që kishte në përdorim mjetin e markës Mercedes Benz me targa AA068EJ. Këta shtetas ka dyshime të rasyeshme se takimin e kanë bërë në funksion të organizimit të punës për trafikimin e një sasive lëndë narkotike nga Kosova në Shqipëri.

Nga studimi i transkripteve të përgjimit të datave 20.05.2015 dhe 21.05.2015 rezulton se shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 00355699921623 ka komunikuar me telefon dhe me mesazhe me shtetasin Arif Çiço i cili përdor numrin e telefonit 0038649311825 ku sipas këtyre transkripteve rezulton se Jurgeni pret përgjigje nga Arifi. Më datë 21.05.2015 në orën 20:00:41 Jurgeni i dërgon mesazh me tekst „Se shum te vorun o vlla thu po te bejn naj loj prap vlla“, në orën 20:00:56 Arifi i dërgon mesazh me tekst „Jo se i kan 2 kamiona presin bashk mi doganu si heren e kalum vlla“. Në orën 20:02:18 Jurgeni i dërgon mesazh me tekst „ Po neser thu po kryhet si e sheh ti se po rendohemi shum me ato dreq perqinjesh o vlla“. Në orën 20:04:38 Arifi i përgjigjet duke i dërguar mesazh me tekst „ e d vlla po un jam me ta nuk ka prob tjetet veq t doganojn qka tbajn ket jav mbarojm“.

Nga studimi i raportit të shërbimit të datës 22.05.2015 rezulton se shtetasi Jurgen Molla është konstatuar në vendin e quajtur „Kompleksi Molla“, me mjetin BMĘ X6 me targa AA400LU.

Nga studimi i transkripteve të përgjimit të datës 22.05.2015 rezulton se shtetasi Anest Koromani në numrin e telefonit 00355692218672 e ka telefonuar një shtetas i cili përdor numrin e telefonit 00306949488701 dhe sipas transkripteve rezulton se shtetasi që përdor numrin e telefonit 00306949488701 i



thotë Anestit se, "ma ka heq mendjen dhe ai tel qqe gjoja e kemi per njeri tjetrin as ate se ka te hapur... Te mbarojm me keta dhe smerrem fare keshtu ... rne mire merrem me keto xhingla minglat e vogla dhe e pyet Anestin se, "Miri? është vetë apo". Anesti i pergjigjet se, "vete them qe andej", më pas shtetasi tjetër e pyet, "fol njehere sa ashtu?" dhe Anesti i pergjigjet se, "i thashe po aty rreh tek 1.6 - cja .... meri fotografi shikoji po na intereso mire". Shtetasi që përdor numrin e telefonit 00306949488701 i thotë se, "po lozin poshte forte 1.7 ata o vlla, pse ti futesh asaj valle", ndërsa Anesti i thotë se, "po qe se jan atje ku duhet ata mbarojne per 2 dite e kupton, do thuash jane gjera .... ne jerni pa cigare". Shtetasi që përdor numrin e telefonit 00306949488701 i thotë se, "rrezikon shume per asgje. Sjell tani ate te ngelet, te sjell 700 mangut, 800 mangut.... plus 2 luli guli, 500 ? Juli Kristua? I di ato muhabete i ti". Anesti i thotë se, "po qe se jan mire, do mundohem tia ulim me nje pike, na leverdis ... mua mu duken te mire".

Nga studimi i raportit të shërbimit të datës 23.05.2015 shtetasi Anest Koromani është konstatuar në zonën e Yzberishtit, në kompleksin e Pallateve E - 88. Anesti ka qënë në mjetin me targa AA221IS i cil është në pronësi të tij dhe sëbashku me të në mjet ndodhej dhe një shtetas tjetër rreth 35 vjeç. Mjeti ka kaluar nga Yzberishti në Mézez dhe më pas ka hyrë në autostradën Tiranë Durrës.

Nga studimi i raportit të shërbimit të datës 26.05.2015 rezulton se në lokalim me mbishkrimin, "Kukësianët Vëllezërit Gjana" kanë ardhur dy shtetas me mjetin e markës Golf 5, ngjyrë gri, me targa 06 337 - BG të cilët në orën 18:15 janë takuar me shtetasin Jurgen Molla i cili erdhi në takim me mjetin mercedes Benz, ngjyrë e zezë me targa AA343LA. Ndërkohë që në orën 19:15 brenda ambienteve të Kompleksit Molla, në zonën e unazës së re janë konstatuar të parkuara mjetet me targa mercedes Benz, ngjyrë e zezë me targa AA343LA dhe automjeti i markës Bittëll me ngjyrë të zezë me targa 06-919AB. Në autojmetin e markës Bittëll me ngjyrë të zezë me targa 06-919AB ndodhej shtetasi Arif Çiço.

Nga studimi i raportit të shërbimit të datës 29.05.2015, dhe përgjimi i bisedave të numrave të shtetasve Arif Çiço, Jurgen Molla, Klaudio Veizi dhe Orges Myftaraj rezulton se është konstatuar në P.K.K Morinë shtetasi Arif Çiço, i cili ka qënë në mjetin me targa 06 919 AB. Më pas mjeti ka vazhduar lëvizjen në intenerain Morinë - Kukës - Tiranë. Në orën 18:00 automjeti me targa 06 919 AB ka ndaluar tek kompleksi, "Molla". Aty shtetasi Arif Çiço është takuar me shtetasin Jurgen Molla. Në orën 18:20 automjeti me targa 06 919 AB ka dalë nga



SEKRET

kompleksi „Molla“ dhe ka vazhduar lëvizjen në drejtim të zonës së Don Boskos, janë takuar me një shtetas rreth 44 vjeç me fokë të shkurtra, pak i shëndoshë dhe janë ulur në një lokal pa emër. Më pas rreth orës 19:39 shtetasi Arif Çiço ka shkuar sëbashku me shtetasin tjetër që e shoqëronte në hotelin „Real Park“, i cili ndodhet në autostradën Tiranë Durrës në zonën e Komunës Kashar. Lekët për fjetjen në këtë hotel për këta shtetas i ka paguar shtetasi Jurgen Molla. Më pas rreth orës 21:05 shtetasi Arif Çiço sëbashku me shtetasin që e shoqëronte kanë shkuar në zonën e Don Boskos, kanë ndaluar në afërsi të fabrikës së këpunëve „Filanto“, kanë marrë shtetasin Klaudio Veizaj dhe kanë darkuar me të në zonën e ish bllokut tek Piceri „Era“.

Nga studimi i raportit të shërbimit të datës 30.05.2015 dhe përgjimi i bisedave të shtetasve Jurgen Molla, Arif Çiço dhe Anest Koromani ka rezultuar se në orën 11:23 shtetasi Anest Koromani me numrin e telefonit 0692218672 i ka shkruar një mesazh Jurgenit në numrin e telefonit 0696999935 me tekst „Vdha si te kame kemi ndonje gje te re“ dhe në orën 11:24 shtetasi Jurgen Molla i ka kthyer një mesazh me tekst „ne reg a vlla po sa te qoj pa ashtu se spo bahen bashk me zor po do i kry vet“. Në orën 17:45 pranë lokalit „Vëllezërit Gjana Kukxianët“ është konstatuar shtetasi Arif Çiço sëbashku me shtetasin rreth 40 vjeç të cilët kanë hyrë në ambientet e këtij lokali dhe janë takuar me dy shtetas të cilët kishin ardhur për tek ky lokal me mjetin Mercedes Benz me targa 04 612 BT. Këta katër shtetas pasi kanë qëndruar pak në këtë vend kanë shkuar në verdin e quajtur kompleksi Molla, tek lokal Enigma dhe janë takuar me shtetasin Jurgen Molla, i cili po lëvizte me mjetin me targa AA343LA. Në orën 20:00 janë konstatuar të dalin nga ambientet e kompleksit „Molla“ automjetet me targa AA343LA, 06 919 - AB dhe 04 612 BT.

Shtetasi Anest Koromani, i cili ka pasur më parë emrin Safet Koromani me numrin e telefonit 0692218672 më datë 30.05.2015 në orën 23:37 i ka telefonuar numrit të telefonit 0695599231 dhe ky i fundit i thotë se „unë thashë bëje 20 me 20 . Safeti i thotë se „ore ashtu i bënë 20 me 20 po ashtu erdhi porosia për kokë të qunave“.

Gjithashtu më datë 31.05.2015 në orën 10:16, Safeti i telefonon një shtetas i cili përdor numrin e telefonit 0692351736 dhe Safeti e pyet „Erdhi ai i vogli“. Shtetasi i cili disponon numrin e telefonit 0692351736 i thotë se „erdhi ajo qeska e farmacisë ca ishte ajo me“. Safeti i përgjigjet „e ato janë të voglat, kurse ato si ka mbështjellë ashtu janë të mëdhajat“.




SEKRET

Nga veprimet e vëzhgimit të fshehtë të kryer më datë 01.06.2015 në orën 12:30' është konstatuar se në rrugën "Don Bosko", në afërsi të karburant "Er Petrol" automjeti i markës BMË X6, me ngjyrë gri, me targa AA400LU. Në ato momente është konstatuar edhe personi i moshës rreth 30 vjeç, i qethur shkurt, pak i shëndoshe, veshur me bluzë, pantallona xhins treçerekëshe me ngjyrë të zeza (i njëjti person që lëviz me automjetin e markës Benz Mercedes me ngjyrë të zezë, me targa AA343LA). Në orën 13:05' personi i lartpërmendur është takuar me dy persona të tjerë dhe është ulur në ambientete e jashtme të një lokali me mbishkrim Tabaco Shop, në afërsi të karburant "Er Petrol". Në orën 13:50' personi i moshës rreth 30 vjeç, është ngritur nga tavolina dhe ka lëvizur në këmbë rreth 50 m në drejtim të Unazës. Aty është takuar me një person rreth moshës 45 vjeç, veshur me bluzë ngjyrë të zezë, i cili ka zëritur nga automjeti i markës Porsche, me ngjyrë të zezë, me targa AA260JO.

-Nga veprimet e vëzhgimit të fshehtë të kryer më datë 02.06.2015 në orën 19:00' është konstatuar automjeti i markës Mercedes Benz, me ngjyrë gri, me targa AA656FA, i parkuar përpara Shkollës 9-vjeçare "Qazim Turdiu" në rrugën "Don Bosko". Gjatë kësaj kohe është konstatuar i ulur në një lokal pa emër shtetasi Arif Çoço së bashku me dy persona. Njëri i moshës rreth 35 vjeç, me flokë të shkurtra dhe tjetri ishte edhe personi i moshës rreth 38 vjeç, me flokë të qethura shkurt, i shëndoshe, veshur me bluzë ngjyrë blu, pantallona xhins ngjyrë blu (i njëjti person që ishte drejtues i automjetit me targa 06 919-AB në datën 29.05.2015, kur kanë kaluar pikën e kalimit kufitar Morinë).

Në orën 19:20' shtetasi Arif Çoço së bashku me personin e moshës rreth 38 vjeç me flokë të qethura shkurt, i shëndoshe, veshur me bluzë ngjyrë blu, pantallona xhins ngjyrë blu, kanë dalë nga lokali ku ishin ulur dhe kanë hipur së bashku në automjetin me targa AA565FA. Më pas vazhdojnë lëvizjen në drejtim të rrugës "Albanopuli", ku në afërsi të një supermarketi ndalojnë, zbresin nga automjeti dhe qëndrojnë duke biseduar në telefon rreth 5 minuta. Në ato momente është afruar një person i moshës rreth 52 vjeç, me flokë pak të gjata (bisht pëllumb), i veshur me këmish të zezë, pantallona të zeza. Pasi është takuar me dy personat e lart përmendur kanë hipur të tre në automjetin me targa AA565 FA dhe kanë lëvizur nën itinerarin Spitali Ushtarak rruga "Dritan Hoxha", sheshi "Sheshi Shqiponja", autostrada "Tiranë-Durrës", mbikalimi Rinasit, rruga Rinasit, Fush Krujë dhe më pas në Laç.



SEKRET



-Nga studimi i raportit të vëzhgimit të fshehtë të kryer më datë 03.06.2015 në orën 17:30' është konstatuar automjeti i markës Mercedes Benz, me ngjyrë gri, me targa AA656FA i cili ka lëvizur ne itinerarin rruga "5 Maji", rruga "Asim Vokshi", Sheshi "Rilindja", rruga "Dritan Hoxha", sheshi "Shqiponja" dhe në drejtim të Kamzës. Në orën 17:45' automjeti me targa AA565FA ndaloi tek karburant "Kastrati". Nga automjeti ka zbritur shtetasi Arif Çoço së bashku me dy persona, njëri i moshes rreth 35 vjeç, me flokë të shkurtra, i veshur me bluzë me ngjyrë të bardhë dhe tjetri ishte personi i moshës rreth 38 vjeç, me flokë të qethura shkurt, i shëndoshë, veshur me xhup, të cilët u ulën në ambientet e jashtme të lokalit pa emër i cili ndodhet tek karburant "Kastrati".

Në orën 18:20' shtetasi Arif Çoço së bashku me dy personat e lart përmendur janë ngritur nga lokali dhe kanë hipur në mjetin me targa AA565FA. Më pas kanë vazhduar lëvizjen në drejtim të Kamzës "Bulevardi Blu", janë kthyer në drejtim të Bathores dhe kanë ndaluar në afërsi të lokal "Bytyçi" në rrugën "Demokracia". Aty ka zbritur nga mjeti shtetasi i moshës rreth 35 vjeç, ndërsa automjeti me targa AA565FA ka vazhduar rrugën në drejtim të Kamzës, mbikalimi "Casa Italia", është kthyer në rrugën dytësore Tirane-Durrës ku ka vazhduar në drejtim të Kasharit. Në orën 20:15' automjeti me targa AA565FA, është parkuar në rrugën "Abdyl Frashëri", ndërsa shtetasi Arif Çoço dhe personi i moshës rreth 38 vjeç janë ulur me dy persona të tjerë të moshave 45-50 vjeç, në ambientet e jashtme të lokal "Kolonat". Në orën 20:25' shtetasi Arif Çoço së bashku me tre personat që ishte ulur në tavolinë ikin nga lokali. Shtetasi Arif Çoço dhe personi i moshës rreth 38 vjeç kanë hipur në mjetin me targa AA565FA, ndërsa dy personat e moshës rreth 45-50 vjeç janë larguar në këmbë ku janë takuar me një femër të moshës rreth 45 vjeç, me flokë të gjata ngjyrë gështenj, veshur me fustan. Pas takimit janë ulur në ambientet e jashtme të një lokali përballë me lokal "Kolonat", ku kanë qëndruar disa minuta dhe më pas dalin nga lokali dhe hipin në automjetin e markës Passat, ngjyrë e verdhë taksi, me targa AA103T.

-Nga studimi i raportit të vëzhgimit të fshehtë të kryer më datë 05.06.2015 në orën 08:15' është konstatuar automjeti i markës Mercedes Benz, me ngjyrë blu, me targa AA221IS në lëvizje në autostradën Rrogozhinë-Lushnjë-Fier. Automjeti ka ndaluar në afërsi të rrethrotullimit të Lushnjes dhe nga automjeti zbret drejtuesi Anest Koromani i cili ka qëndruar në këmbë përpara automjetit. Gjatë kësaj kohe pranë tij ka ndaluar automjeti i markës Mercedes-Benz minibus,



ngjyrë kafe, me targa AA385LE, nga ky automjet ka zbritur një person i moshës rreth 35 vjeç, me flokë të shkurtra, me syze dielli, veshur me bluzë me ngjyrë të bardhë, tuta me ngjyrë të zezë, i cili është takuar me shtetasin Anest Koromani dhe kanë hipur më pas në automjetin me targa AA221IS dhe kanë lëvizur në drejtim të autostradës Lushnje-Fier.

Në orën 09:35' automjeti me targa AA221IS, ka ndaluar tek mbikalimi i Levanit dhe në mjet ka hipur një person i moshës rreth 40 vjeç, me flokë të rëna para, veshur me bluzë me vija bardhë e zi, pantallona xhins ngjyrë blu, më pas mjeti ka vazhduar lëvizjen në drejtim të Vlorës.

Në orën 09:55' mjeti me targa AA221IS, ka ndaluar në hyrje të qytetit të Vlorës tek lokal "Dino Bar", nga mjeti kanë zbritur të tre personat dhe janë takuar në ambientet e jashtme të lokalit me një person tjetër i moshës rreth 42 vjeç, qeros, veshur me bluzë me vija, të cilët më pas janë ulur së bashku në ambientet e jashtme të lokalit. Në orën 10:10' shtetasi Anest Koromani së bashku me personat e moshës 35 dhe 40 vjeç janë ndarë nga personi i moshës 42 vjeç, hipin në mjetin me targa AA221IS dhe kanë lëvizur në drejtim të Skelës në qytetin e Vlorës dhe kthehen përsëri në drejtim të bulevardit "Ismail Qemali", ku në afërsi të sheshit pranë xhamisë kanë ndaluar dhe kanë zbritur nga mjeti, kanë hyrë në ambientet e një lokali me mbishkrim "Piceri". Pas disa minutash nga lokali me mbishkrim "Piceri" ka dalë personi i moshës rreth 40 vjeç, i cili është takuar me një person rreth 40-45 vjeç, i cili ka mbajtur në kokë një kapele me ngjyrë të zezë, veshur me bluzë ngjyrë blu, pantallona xhins. Ky person ka ardhur aty me një mjet tip Fiat Punto, ngjyrë blu, dhe ka qënë ulur në vëndin e pasagjerit. Pasi janë takuar të dy, kanë hyrë në lokalin ku ishte ulur shtetasi Anest Koromani dhe personi i moshës rreth 35 vjeç. Gjatë kësaj kohe personi i moshës rreth 40 vjeç ka qëndruar jashtë lokalit në këmbë ndërkohë që personat e tjerë po bisedonin me njëri-tjetrin. Pas 2-3' më vonë nga lokali ka dalë edhe personi i moshës rreth 35 vjeç i cili ka biseduar me personin e moshës rreth 40 vjeç, ndërsa Anest Koromani dhe personi i moshës rreth 40-45 vjeç, me kapele të zezë kanë qëndruar në lokal duke biseduar me njëri-tjetrin. Në orën 10:45' të katër personat kanë dalë nga lokali dhe kanë shkuar në këmbë në një lokal tjetër në Bulevardin Ismail Qemali. Në orën 11:10 pasi dalin të katër nga lokali, shtetasi Anest Koromani sëbashku me personin e moshës rreth 35 vjeç kanë hipur në mjetin me targa AA221IS dhe janë larguar nga qyteti i Vlorës në drejtim të




autostradës Fier-Lushnje ku kanë marre rrugën në drejtim të Beratit. Ndërsa dy personat e tjerë kanë vazhduar në këmbë në Bulevardin Ismail Qemali.

Në orën 17:40' është konstatuar automjeti i markës Mercedes Benz me targa AA565FA, duke lëvizur në drejtim të "Casa Italia", Sheshi "Shqiponja", rruga "Dritan Hoxha", rruga "Pandi Dardha" dhe ka ndaluar pranë shkollës 9 Vjeçar "Qazim Turdiu". Nga automjeti ka zbritur shtetasi Arif Çoço dhe është takuar me dy persona, njëri ishte i moshës rreth 35 vjeç, me flokë të shkurtra, veshur me bluzë ngjyrë të bardhë, pantallona xhins ngjyrë blu, personi tjetër ishte i moshës rreth 38 vjeç, pak i shëndoshë, veshur me bluzë ngjyrë të zezë, pantallona të zeza, të cilët janë ulur së bashku në një lokal pa emër. Në orën 18:07' shtetasi Arif Çoço së bashku me dy personat e lartpërmendur kanë dale nga lokali dhe kanë hipur në automjetin e markës BMË, seria 7, ngjyrë gri, me targa AAA544JJ dhe kanë lëvizur në drejtim të rrugës "Don Bosko". Pasi kanë mbërritur pranë karburant "Eli", shtetasi Arif Çoço së bashku me personin e moshës rreth 38 vjeç, kanë zbritur nga mjeti BMË dhe janë afruar te mjeti i markës Hummer, ngjyrë e zezë, me targa AA400JS, e cila ndodhej e parkuar tek karburanti. Në vëndin e parë të këtij automjeti ka qënë një femër, gjatë kësaj kohe shtetasi Arif Çoço ka biseduar për disa minuta me personin e moshës rreth 38 vjeç dhe janë ndarë. Ku shtetasi Arif Çoço është larguar sëbashku me personin e moshës rreth 35 vjeç me automjetin me targa AA544JJ, ndërsa personi i moshës rreth 38 vjeç ka hipur në mjetin me targa AA400JS ku kanë lëvizur në drejtim të Unazës. Automjeti me targa AA544JJ, ka ndaluar tek shkolla 9 vjeçare "Qazim Turdiu", nga mjeti ka zbritur shtetasi Arif Çoço dhe ka hipur në automjetin e tij me targa AA565FA dhe ka lëvizur në drejtim të sheshit "Shqiponja", autostrada Tiranë-Durrës.

Nga studimi i transkripteve të përgjimit rezulton se më datë 07.06.2015 në orën 22:08 shtetasin Anest Koromani e telefonon në numrin e telefonit 0692218672 një shtetas i cili disponon numrin e telefonit grek 00306980932959 dhe Safeti e pyet, 'kush je?'. Shtetasi tjetër i thotë se, "Safet ti je ore?". Shtetasi i cili përdor numrin e telefonit 0692218672 i përgjigjet, "E". Këtu shtetasi Safet Koromani vetidentifikohet.

-Nga studimi i raportit të vëzhgimit të fshehtë të kryer më datë 09.06.2015 në orën 20:00' në ambientet e jashtme të lokal "E4A", në bulevardin "Gjergj Fishta" është konstatuar femra e e njohur me emrin Lili e moshës rreth 25-28 vjeç, me flokë të zeza të gjata, veshur me bluzë ngjyrë të bardhë, fund me ngjyrë të zi,



SEKRET

autostradës Fier-Lushnje ku kanë marre rrugën në drejtim të Beratit. Ndërsa dy personat e tjerë kanë vazhduar në këmbë në Bulevardin Ismail Qemali.

Në orën 17:40' është konstatuar automjeti i markës Mercedes Benz me targa AA565FA, duke lëvizur në drejtim të "Casa Italia", Sheshi "Shqiponja", rruga "Dritan Hoxha", rruga "Pandi Dardha" dhe ka ndaluar pranë shkollës 9 Vjeçar "Qazim Turdiu". Nga automjeti ka zbritur shtetasi Arif Çoço dhe është takuar me dy persona, njëri ishte i moshës rreth 35 vjeç, me flokë të shkurtër, veshur me bluzë ngjyrë të bardhë, pantallona xhins ngjyrë blu, personi tjetër ishte i moshës rreth 38 vjeç, pak i shëndoshë, veshur me bluzë ngjyrë të zezë, pantallona të zeza, të cilët janë ulur së bashku në një lokal pa emër. Në orën 18:07' shtetasi Arif Çoço së bashku me dy personat e lartpërmendur kanë dale nga lokali dhe kanë hipur në automjetin e markës BMË, seria 7, ngjyrë gri, me targa AAA544JJ dhe kanë lëvizur në drejtim të rrugës "Don Bosko". Pasi kanë mbërritur pranë karburant "Eli", shtetasi Arif Çoço së bashku me personin e moshës rreth 38 vjeç, kanë zbritur nga mjeti BMË dhe janë afruar te mjeti i markës Hummer, ngjyrë e zezë, me targa AA400JS, e cila ndodhej e parkuar tek karburanti. Në vëndin e parë të këtij automjeti ka qënë një femër, gjatë kësaj kohe shtetasi Arif Çoço ka biseduar për disa minuta me personin e moshës rreth 38 vjeç dhe janë ndarë. Ku shtetasi Arif Çoço është larguar sëbashku me personin e moshës rreth 35 vjeç me automjetin me targa AA544JJ, ndërsa personi i moshës rreth 38 vjeç ka hipur në mjetin me targa AA400JS ku kanë lëvizur në drejtim të Unazës. Automjeti me targa AA544JJ, ka ndaluar tek shkolla 9 vjeçare "Qazim Turdiu", nga mjeti ka zbritur shtetasi Arig Çoço dhe ka hipur në automjetin e tij me targa AA565FA dhe ka lëvizur në drejtim të sheshit "Shqiponja", autostrada Tiranë-Durrës.

Nga studimi i transkripteve të përgjimit rezulton se më datë 07.06.2015 në orën 22:08 shtetasin Anest Koromani e telefonon në numrin e telefonit 0692218672 një shtetas i cili disponon numrin e telefonit grek 00306980932959 dhe Safeti e pyet 'kush je?'. Shtetasi tjetër i thotë se, "Safet ti je ore?". Shtetasi i cili përdor numrin e telefonit 0692218672 i përgjigjet, "E". Këtu shtetasi Safet Koromani vetidentifikohet.

-Nga studimi i raportit të vëzhgimit të fshehtë të kryer më datë 09.06.2015 në orën 20:00' në ambientet e jashtme të lokal "E4A", në bulevardin "Gjergj Fishta" është konstatuar femra e njohur me emrin Lili e moshës rreth 25-28 vjeç, me flokë të zeza të gjata, veshur me bluzë ngjyrë të bardhë, fund me ngjyrë të zi,



SEKRET

e cila ka qënë ulur në tavolinë me tre persona, dy meshkuj dhe një femër e moshës rreth 25 vjeçe, me flokë të gjata kaçurrela të lyera me fije të verdha, veshur me bluzë me ngjyrë të bardhë, pantallona xhins. Personi i parë mashkull ishte i moshës 38 vjeç, me flokë të shkurtra të zeza, pak ezmer, veshur me bluzë ngjyrë gri, pantallona xhins, ndërsa personi i dytë mashkull ka qënë rreth 35 vjeç, me flokë të shkurtra, veshur me bluzë ngjyrë të bardhë pantallona xhins. Në orën 21:00' femra e njohur me emrin Lili e moshës rreth 25-28 vjeç, është ngritur nga tavolina dhe ka hipur në automjetin e markes Volzëagen Golf, me ngjyrë gri, me targa AA011KU, dhe ka lëvizur në drejtim të rrugës së "Elbasanit".

Ndërkohë në lokalin "E4A", kanë qënë duke biseduar në ambientin e jashtëm të tij dy personat meshkuj të moshës 38 dhe 35 vjeç. Në orën 21:20' personi i moshës 35 vjeç është ndarë me personin e moshës 38 vjeç, ku ka hipur si drejtues në automjetin e markës Mercedes Benz, ngjyrë e zezë, me targa AA060EC, ndërsa personi i moshës rreth 38 vjeçka hipur në automjetin e markës Volzëagen, me ngjyrë gri, me targa AA989FT. Te dy automjetet kanë lëvizur në drejtim të pallatit me shigjeta.

-Nga studimi i raportit të vëzhgimit të fshehtë të kryer më datë 10.06.2015 në orën 19:00' është konstatuar automjeti i markës Volzëagen Golf, ngjyrë gri, me targa AA011KU, i parkuar në afërsi të lokalit "E4A". Në orën 19:30' është parkuar para lokalit "E4A", automjeti i markës Mercedes Benz, me ngjyrë të zezë, me targa AA060EC. Nga automjeti ka zbritur drejtuesi, person i moshës rreth 35 vjeç, me flokë të shkurtra, veshur me bluzë ngjyrë gri, pantallona gri dhe femra e njohur me emrin Lili e moshës rreth 25-28 vjeçe. Të dy sëbashku kanë hyrë në ambientet e lokalit dhe kanë dalë sërish duke biseduar pranë mjetit në këmbë. Në orën 19:40' pranë lokal "E4A" është parkuar automjeti i markës BMË X6, me targa AA400LU dhe nga mjeti ka zbritur drejtuesi i moshës rreth 30 vjeç, me flokë të shkurtra, pak i shëndosh, veshur me bluzë ngjyrë vishnje, pantallona xhins dhe pasagjeri person i moshës rreth 38 vjeç, me flokë të shkurtra të zeza, pak ezmer, veshur me bluzë lejla, pantallona xhins (i cili është po i njëjti person që është takuar me femrën e njohur me emrin Lili e moshë 25-28 vjeç në datën 09.06.2015 tek lokal "E4A" dhe që u largua me automjetin me targa AA989FT). Të dy këto persona janë afruar tek femra e njohur me emrin Lili dhe tek personi i moshës rreth 35 vjeç i cili po bisedonte me të jashtë lokalit dhe kanë hyrë të katër brenda në lokal "E4A". Femra e njohur me emrin Lili dhe personi i moshës rreth 30 vjeç me flokë të shkurtra, pak i shëndoshe, veshur me bluzë ngjyrë vishnje, pantallona xhins janë ulur vetëm në një tavolinë, ndërsa dy personat e tjerë kanë

qëndruar vetëm në një tavolinë tjetër. Pas disa minutash janë bashkuar të katër në një tavolinë. Në orën 20:30' femra e njohur me emrin Lili së bashku me tre personat që ishte në tavolinë kanë dalë nga lokali, kanë hipur në mjetin e markës BMË X6, me targa AA400LU, dhe kanë lëvizur në drejtim të bulevardit "Bajram Curri". Në orën 21:05' automjeti me targa AA400LU është konstatuar i parkuar në krah të rrugës tek ish fusha e Aviacionit. Ndërsa femra e njohur me emrin Lili së bashku me dy personat e moshës rreth 30 dhe 38 vjeç dali nga një lokal pa emër që ndodhet tek ish fusha e Aviacionit, hipin të tre së bashku në automjetin me targa AA400LU dhe lëvizin në drejtim të sheshit "Skënderbej".

-Nga studimi i raportit të vëzhgimit të fshehtë të kryer më datë 11.06.2015 në orën 13:15' është konstatuar automjeti i markës BMË, ngjyrë gri, me targa AA400LU, e parkuar në parkingun privat pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda. Ndërsa shtetasia e njohur me emrin Lili është ulur në lokal "Class" në ambientet e jashtme së bashku me personat e moshës 38, 35 vjeç dhe 30 vjeç (të tre këta persona janë takuar me femrën e njohur me emrin Lili më datën 09.06.2015 dhe datën 10.06.2015). Në orën 13:30' personi i moshës rreth 38 vjeç, me flokë të shkurtra, veshur me bluzë ngjyrë lejla, pantallona xhins është ngritur nga tavolina, përshëndeten me personat dhe largohet në këmbë në Unazë në rrugën "Asim Vokshi", ku hipën në një taksì Passat, ngjyrë të verdhë, vazhdon lëvizjen në drejtim të sheshit "Rilindja".

Në orën 13:35' personi i moshës rreth 30 vjeç, me flokë të shkurtra i shëndoshë, veshur me bluzë ngjyrë të zezë, pantallona xhins, ka dalë nga lokali ka marre në parking mjetin me targa AA400LU, dhe ka ndaluar para lokalit "Class" duke pritur. Ndërsa femra e njohur me emrin Lili dhe personi i moshës rreth 35 vjeç qëndruan në lokal duke biseduar me njëri tjetrin.

Në orën 14:30' femra e njohur me emrin Lili dhe personi i moshës rreth 35 vjeç dalin nga lokali dhe hipin në automjetin me targa AA400LU dhe lëvizin në drejtim e Prokurorisë së Rrethit. Nga automjeti ka zbritur personi i moshës rreth 35 vjeç, i cili ka hyrë në ambientet e një lokali ku qëndroi rreth 2-3' më pas del dhe hipën përsëri në automjet duke vazhduar në drejtim të sheshit "Rilindja", ku ndaluan në afërsi të karburant "Er Petrol". Nga automjeti zbresin, drejtuesi personi i moshës rreth 30 vjeç dhe pasagjeri personi i moshës rreth 35 vjeç, të cilët u takuan me një person tjetër të moshës rreth 38 vjeç, me flokë të shkurtra, veshur me bluzë me ngjyrë të bardhë, pantallona xhins, ndërsa femra e njohur me emrin Lili qëndroi brënda në automjet. Personi i moshës rreth 38 vjeç, veshur me bluzë ngjyrë të bardhë kaloi në krahun tjetër të rrugës, hyri në një dyqan me



S E K R E T

mbishkrim "Pastiçeri" ku mori një qese e cila kishte brënda një kuti. Më pas kaloi rrugën dhe afrohet te dy personat të moshës 35 dhe 30 vjeç. Të tre këta persona së bashku me një person tjetër qëndruan jashtë ambienteve të lokalit me mbishkrimin Tabaco Shop, në afërsi të karburant "Er Petrol".

Në orën 14:50' femra e njohur me emrin Lili zbrit nga automjeti me targa AA400LU dhe së bashku me personin e moshës rreth 35 vjeç, hipin në automjetin e markës Volzëagen Golf 5, ngjyrë gri, me targa AA220KV, me drejtues personin e moshës rreth 35 vjeç ku kanë lëvizur në drejtim të sheshit "Rilindja", ndërsa personi i moshës rreth 30 vjeç qëndroi duke biseduar në këmbë me personin rreth moshës 38 vjeç veshur me bluzë me ngjyrë të bardhë.

Në orën 19:50' është konstatuar automjeti me targa AA400LU duke lëvizur tek fusha e aviacionit, ku pasi mjeti është parkuar kanë zbritur, drejtuesi personi i moshës rreth 38 vjeç, veshur me bluzë ngjyrë të bardhë dhe pasagjer ishte ulur personi i moshës rreth 30 vjeç, të cilët janë ulur në ambientet e jashtme të një lokali pa emër tek fusha e aviacionit. Në orën 20:00' pranë tavolinës së tyre afrohet në këmbë një person tjetër të moshës rreth 33 vjeç, me flokë të shkurtra, veshur me bluzë ngjyrë të bardhë, pantallona xhins i cili është ulur në tavolinë me ta dhe ka biseduar. Në orën 20:30' ngrihen nga tavolina të tre personat dhe personat e moshës 30 dhe 38 vjeç hipin në mjetin me targa AA400LU dhe largohen në drejtim të "21 Dhjetorit", ndërsa personi i moshës rreth 33 vjeç lëvizi në këmbë në drejtim të ish fushës së aviacionit.

Nga hetimet ka dyshime të arsyeshme se shtetasi Jurgen Molla në muajt Maj dhe Qershor me shtetasit që janë konstatuar në raportet e shërbimit të datave 09, 10 dhe 11.06.2015 si dhe bashkëpunëtorë të tjerë kanë tentuar të sajojnë kallzim të bërë nga punonjës të policisë së burgjeve për të bërë të mundur mosekstradimin e shtetasit Armando Idajet Gorezi i datëlindjes 19.11.1975. Këta shtetas në bashkëpunim me njëri tjetrin ka dyshime të arsyeshme që kishin paguar para për të korruptuar zyrtarë të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për mosekstradimin e shtetasit Armando Gorezi në drejtim të Italisë. Shtetasi Armando gorezi ishte kapur nga policia e shtetit pasi ishte shpallur në kërkim nga ZQK Interpol Tirana pasi, Gjykata Torino/ Itali kishte lëshuar urdhërin e arrestit nr.5364/12RGNR- 24320/13 RG GIP dt.06.05.2014. V.Penale "Vrasje" parashikuar nga nenet 575, 577 të K.Penal Italian. Ky shtetas ishte ndaluar me qellim ekstradimi drejt Italisë. Çështja po ndiqej nga Prokuroria e rrethit Gjyqësor Tiranë.



S E K R E T

S E K R E T

-Nga studimi i raportit të vëzhgimit të fshehtë të kryer më datë 15.06.2015 në orën 15:35' është konstatuar automjeti i markës Mercedes Benz, ngjyrë gri, me targa AA565FA duke lëvizur tek rreth rrotullimi i qendrës tregtare "TEG" në drejtim të Elbasanit. Në automjet ndodheshin tre persona, drejtuesi një person i moshës rreth 38 vjeç, i shëndosh, veshur me bluzë ngjyrë gri me të bardhë (i njëjti person që ishte me datë 03.06.2015 me shtetasin Arif Çoço i ulur pasagjer në automjetin me targa AA565FA, pasagjeri i ulur në vëndin e parë ka qënë një person i moshës rreth 45 vjeç, qeros, i shkurtër, veshur me bluzë me mëngë të gjata ngjyrë të zezë, pantallonan të zeza, ndërsa shtetasi Arif Çoço ishte ulur në vëndin e pasëm të automjetit.

Në orën 16:25' automjeti me targa AA565FA ndalon tek karburant "Eldio" e cila ndodhet në hyrje të qytetit në aksin e rrugës Elbasan-Metalurgji. Nga automjeti zbresin shtetasi Arif Çoço së bashku me dy personat e moshës rreth 38 dhe 45 vjeç, të cilët u ulën në ambientet e lokalit që ndodhëf tek karburanti. Aty janë takuar me katër persona të tjerë të moshave të ndryshem të cilët po i prisnin. Të gjithë personat qëndruan së bashku duke biseduar në një tavolinë. Përpara lokalit ishin të parkuar në afërsi të automjetit me targa AA565FA edhe dy automjete, automjeti i markës Ford Focus, ngjyre blu e hapur me targa SK030FL dhe automjeti i markës Opel Astra, ngjyrë e zezë, me targa 34JIS27. Gjatë kësaj kohe shtetasi Arif Çoço sëbashku me një person të moshës rreth 35 vjeç, qeros, veshur me bluzë ngjyrë të zezë, pantallona të zeza, dolën nga lokali dhe kanë biseduar jashtë për disa minuta dhe më pas hyjn në lokal. Pas 5' shtetasi Arif Çobo dhe personat që erdhën me të nga Tirana të moshes 45 dhe 38 vjeç, kanë dalë disa herë nga lokali duke biseduar dhe më pas u ulën në lokal duke biseduar me personat e tjerë.

Në orën 16:45' shtetasi Arif Çiço ka dalë nga lokali sëbashku me një person të moshës rreth 60 vjeç, me flokë te shkurtra të thunjura, me syze optike, veshur me këmishë të bardhë i cili ishte një nga personat që po e prisnin atë në lokal. Pasi kanë biseduar për disa minuta jashtë, kanë hyrë sërish në lokal dhe janë ulur në tavolinë me personat e tjerë.

Në orën 17:10' shtetasi Arif Çoço së bashku me personat e moshës 45 dhe 38 vjeç që erdhën bashkë nga Tirana, dalin nga lokali dhe hipin në automjetin me targa AA565FA dhe vazhdojnë lëvizjen drejt Tiranës.

Në orën 21:00' është konstatuar automjeti i markës Mercedes Benz, ngjyrë gri, me targa AA565FA duke lëvizur nga rreth rrotullimi i qendres tregtare TEG



S E K R E T



SEKRET

në drejtim të autostradës Tiranë-Durrës, në mjet ndodhej drejtuesi personi i moshës rreth 38 vjeç dhe shtetasi Arif Çoço. Mjeti ka ndaluar tek karburant "Kastrati" në Vorë ku nga automjeti ka zbritur shtetasi Arif Çoço i cili ka shkuar në drejtim të lokalit, ndërsa drejtuesi, personi i moshës rreth 38 vjeç qëndroi tek automjeti. Rreth 2-3' më pas tek karburant "Kastrati" afrohet një automjet i markës Audi, ngjyrë e zezë me targa AA456JX, ku ndodheshin dy persona dhe pranë automjetit tip Audi është afruar personi i moshës rreth 38 vjeç dhe bisedon me drejtuesin e Audit nga xhami i makinës. Në atë moment afrohet edhe shtetasi Arif Çoço tek automjeti tip Audi dhe bisedon me personat që ndodheshin në të. Më pas shtetasi Arif Çoço sëbashku me personin e moshës rreth 38 vjeç hipin në mjetin me targa AA565FA vazhdojnë lëvizjen në autostrad dhe pas tyre ka lëvizur edhe automjeti me targa AA456JX.

Më datë 19.06.2015 në orën 21:36, shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 0692411117 i telefonon shtetasit Orges Myftaraj në numrin e telefonit 0699409888 dhe i kërkon këtij të fundit, 'ej na pyet iher Klajdin mos ka fol, mos ka ndonjë numër, mos ka fol kto dit me at, mos ka noi numur të atij, edhe mos ka ndonjë numur të lubos". Lubo thërritet ndryshe shtetasi Arif Çiço. Ndërkohë që Orgesi i thotë se, "a do ta nis fare atje un" për Klajdin, por Jurgeni i thotë që, "nuk do me e nis atje".

Më datë 23.06.2015 në orën 10:43 dhe 11:14, shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 0692411117 komunikon me një shtetas i cili përdor numrin e telefonit 0692677046 dhe sëbashku e lënë të shkojnë në Kosovë.

Nga studimi i raportit të shërbimit 23.06.2015 shtetasi Jurgen Molla është konstatuar duke lëvizur nga rruga, "Don Bosko" me mjetin e markës BMË X6 me targa AA400LU dhe ka shkuar në lokal, "Arbes Kafe". Në këtë vend ka ardhur dhe shtetasi Arif Çiço me mjetin Mercedes Benz me targa AA565FA. Më pas në orën 13:10 shtetasi Jurgen Molla me mjetin e markës BMË X6 me targa AA400LU është konstatuar duke dalë nga Shqipëria në drejtim të Kosovës, nëpërmjet PKK Morinë. Në Kosovë ka shkuar në shoqërinë e shtetasit Mariglen Gramos Aliaj i datëlindjes 16.10.1976. Ndërkohë që në orën 13:14 minuta rezulton të jetë larguar në drejtim të Kosovës edhe shtetasi Arif Çiço. Shtetasit Jurgen Molla dhe Mariglen Aliaj, janë kthyer nga Kosova po më datë 23.05.2015 me mjetin me targa AA400LU.

Nga përgjimi i bisedave telefonike të zhvilluara midis shtetasve Jurgen Molla, Orges Myftaraj, Arben Prendi dhe Arif Çiço në datat 27.06.2015,



SEKRET

SEKRET

28.06.2015 e 29.06.2015 rezultoi se shtetasi Jurgen Molla në bashkëpunim me shtetasin Anesti Koromani organizuan trafikimin e një sasive lëndë narkotike të llojit heroinë nga Kosova në Shqipëri me destinacion final Greqinë dhe vendet e tjera të BE-së. Shtetasi Anesti Koromani dhe Jurgen Molla kanë siguruar lekët për blerjen e lëndës narkotike, ndërkohë që shtetasi Arif Çiço në bashkëpunim me shtetasin Enver Kurtulus dhe një shettas që thërritet Plaku kanë sjellë lëndën narkotike nga Turqia në Kosovë. Shtetasi Jurgen Molla suguruar transportuesin e lëndës narkotike shtetasin Arben Prendi dhe shtetasin i cili ka çuar lekët e lëndës narkotike i cili rezultoi të ishte shtetasi Orges Myftaraj. Shtetasi Orges Myftaraj do të bënte dhe shoërimin e kamionit i cili do të sillte lëqndën narkotike në Shqipëri dhe për këtë do të ndihmohej nga shtetasi Klaudio Veizaj.

Konkretisht, në orën 19:16 shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 0699921623 i ka telefonuar shtetasit Arben Prendi i cili kishte në përdorim numrin e telefonit 0699886936 duke i thënë se, 'A po del deri në gjysë të rrugës takohem?'. Shtetasi Arben Prendi e pyet se, 'Deri në gjysë të rrugës, po more ku je, deri ku po vije une?'. Ndërkaq shettasi Jurgen Molla i thotë se, 'po nisur takohna te Laguna e Patokut te kryqezimi'. Më pas, në orën 19:21 shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 0692441117 ka komunikuar me bashkëshorten e vet që përdor numrin e telefonit 0694388694 duke i thënë se "më ul vetëm ato eurot posht, qesen". Sipas raportit të shërbimit të datës 27.06.2015 në orën 19:21 është konstatuar mjete me targa AA400LU duke lëvizur në drejtim të rrugës, "Don Bosko". Më pas shtetasi Jurgen Molla i ka telefonuar shtetasit Arben Prendi dhe e kanë lënë të takohen në mes të rrugës. Sipas raportit të shërbimit të datës 27.06.2015 në orën 20:22 në vendin e quajtur nënkalimi i Patokut me Laçin është konstatuar automjeti me targa AA400LU, i ndaluar mbrapa një automjeti tjetër BMË X6, ngjyrë e zezë me targa AA300HS, ky i fundit në pronësi të shtetasit Arben Ndue Prendi. Nga mjete me targa AA400LU zbret shtetasi Jurgen Molla dhe takohet me shtetasin Arben Prendi dhe bisedojnë për 10 minuta.

Në orën 20:55 shtetasi Arben Prendi me numrin e telefonit 0699886936 i telefonon një shtetasi në numrin e telefonit 0699812333 duke i thënë se, "Ha more se Beni Jam a te doli ky numër em?" dhe Jurgeni i përgjigjet se, "po", ndërkohë që Beni i thotë se, "Hajë se harrovë së i pata harxhu krejt lekë Gladoli mte m... se me duhen leket mrena jo oferte te ky duke i kërkuar ti fute 10 mijë lekë te iky, ndërsa Jurgeni bie dakort.



SEKRET

SEKRET

Pas takimit me Jurgenin, po më datë 27.06.2015 shtetasi Arben Prendi nëpërmjet PKK Morinë ka udhëtuar në drejtim të Kosovës me kamion.

Gjithashtu më datë 27.06.2015 nga PKK Morinë ka shkuar në Kosovë edhe shtetasi Orges Myftaraj dhe Arif Çiço.

Duke pasur tashmë këto të dhëna në dispozicion, mbi dyshimet e bazuara në provat e marra nga interceptimi telefonik, se nga Kosova në drejtim të Shqipërisë, në datat 27.06.2015, 28.06.2015 e 29.06.2015 do të importohet lëndë narkotike, duke qënë se edhe në Kosovë ka në ndjekje një procedim për këtë rast, ju kërkua autoriteteve kosovare, vazhdimin e hetimeve paralele për dokumentimin e kësaj veprimtarie kriminale si dhe koordinimin e veprimeve në fazën e goditjes për sekuestrimin e lëndës narkotike dhe arrestimin e personi apo personave përgjegjës. Autoritetet kosovare kanë marrë në vëzhgim shtetasit Orges Myftaraj, Arben Prendi, Arif Çiço, Enver Kurtulus dhe shtetas të tjerë në territorin e Kosovës. Gjithashtu autoritetet kosovare na kanë dhënë informacion në kohë reale për lëvizjen e kamionit me targa AA090IF dhe me targë karrocierie AB R 200.


Nga studimi i transkripteve të bisedave të datave 27.06.2015, 28.06.2015 dhe 29.06.2015 rezulton që më datë 27.06.2015 shtetasi Jurgen Molla ka dërguar në Kosovë sasinë e nevojshme të lekëve me anë të shtetasit Orges Myftaraj, ka dërguar gjithashtu dhe shtetasin Arben Prendi me kamionin me targa AA090IF dhe me targë karrocierie AB R 200 për të bërë të mundur transportimin e lëndës narkotike heroinë nga Kosova në Shqipëri.

Më datë 28.06.2015 në orën 00:11:27 shtetasi Orges Myftaraj në numrin e telefonit 0038649686704 telefonohet nga shtetasi Arben Prendi me numrin e telefonit 00355699886936 dhe Arbeni i thotë se „A të tha ai ku me ardehe?“. Orgesi i thotë se „Jo more vlla ktu te rrini jam te center e ke parasysh?“. Ndërsa Beni i thotë se „Po futu rruges takojme ne rruge ore burre“. Orgeni i thotë se „E po s’kam prite te marre nje taksì e te vij se s’kam“. Ndërsa shtetasi Arben Prendi i thotë se „Merre një taksì e futu rrugës se Gjakovës e shehe kamionin te parkum krahit te djathte gjithkone sa te kalosh“. Shtetasi Orges Myftaraj bie dakort. Në orën 00:34 shtetasi Orges Myftaraj me numrin e telefonit 0699409888 i ka dërguar shtetasit Jurgen Molla një sms me tekst , „po iki në dhomë ok mbarova“. Në orën 00:35:08 Jurgeni i dërgon sms me tekst „ e tak at b“ dhe bëhet fjalë për Benin. Në orën 00:35:35 Orgesi i kthen përgjigje me sms me tekst „ Po. po iki ndhomë“ kështu i tregon Jurgenit se Benin e ka takuar dhe se po

SEKRET

SEKRET

shkon në dhomë. Në orën 00:36:34 Jurgeni i dërgon sms me tekst „po thire tak a c qe ta din e me shkruj te tjetri“ duke i kërkuar të flase me shtetasin Arif Çiço. Orgesi në orën 00:37:17 i kthen përgjigje me sms me tekst „Ok. Skam ëirles sa te iki ndhom“. Në orën 00:38:15 Jurgeni i dërgon sms me tekst „Po shkruj me num e ksh te num qe dhash mo po lek i mort“. Orgesi i përgjigjet duke dërguar sms me tekst „Ok“. Në orën 00:48 shtetasi Jurgen Molla i dërgon Orgesit sms me tekst „A u rehatove qnje shkruaj pra me num te ks“. Mbas kësaj në orën 00:48 shtetasi Orges Myftaraj me numrin e telefonit 0038649686704 i dërgon mesazh shtetasit Jurgen Molla në numrin e telefonit 00355699861233 me tekst „U lidha me c . te marr un tha. I thash qe jam ktu“, duke i lënë të kuptojë shtetasit Jurgen Molla se është lidhur me Arifin dhe se i ka thene se është atje. Në orën 00:49 shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 00355699861233 i dërgon mesazh shtetasit Orges Myftaraj në numrin e telefonit 0038649686704 me tekst „ Ok kur te vij tak e me shkruj po mos gabon me mi dhan lekt pa me pyt mu dhe mer ni num te ks qe te lidheni me ben ok“. Në orën 00:50:12 i dërgon një mesazh tjetër me tekst „ I sig lekt i ke ti“. Në Orën 00:50:36 Orgesi i kthrn përgjigje me mesazh me tekst „Po ate po bejm. Jo pa merak“. Në orën 11:04:37 shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 0699861233 i telefonon shtetasit Orges Myftaraj në numrin e telefonit 0038649686704 duke e pyetur „ku është ai?, ai Q ku eshtë“, Orgesi i përgjigjet se „Po ky ky kaloi ktu me një shok, unë e pashë nga larg ktu dhe coi mesazh ndalo i thashe se te pashe ktu. M’tha po iki tash po iki thote kart ke parasysh une po rrije edhe une te nje kapiqe po rrisha ktu kur kaloj e pashe nga larg i thashe ndalu“. Shtetasi Jurgeni Molla e pyet „Po ai shoku, ai shoku tjetër ku a“?. Orgesi i përgjigjet se „ Ai ka hape hrahun diku aty ka parku po ashtu eshte tu prite“. Në orën 11:14:33 shtetasi Arif Çiço me numrin e telefonit 0038649861296 i dërgon një mesazh shtetasit Jurgen Molla në numrin e telefonit 0699861233 me tekst „Shkruj“, në orën 11:14:47 Jurgeni i kthen përgjigje me mesazh me tekst „Vlla te kam shkruj pergj qa je tu ba“. Në orën 11:15:49 shtetasi Arif Çiço i dërgon Jurgenit mesazh me tekst „Tu organizu“. Në orën 11:18:54 Jurgeni i dërgon Arifit Mesazh me tekst „Po un a te thash mer masat qe mram dhe marohet ajo se mos ti la njerezit verdall mos bajm kot zhurm“. Në orën 11:21:06 Arifi i shkruan Jurgenit mesazh me tekst „vlla mos u merzit do mbarohet si ma mir“. Më pas Jurgen i dërgon disa mesazhe ku i kërkon Arif të dijë se cpo bën ky i fundit. Në orën 13:17:38 shtetasi Arif Çiço i dërgon Jurgenit një mesazh me tekst „Vlla tash kismet e krym pa merak te mar un“. Në orën



SEKRET

13:18:12 Jurgeni i dërgon Arifit mesazh me tekst ,“Ok po mos e leni shum von”. Më pas shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 0699861233 ka shkëmbyer vazhdimisht mesazhe me shtetasin Arif Çiço i cili përdor numrin e telefonit 0038649861296 dhe Arifi vazhdimisht i ka thënë se gjerat i ka në rregul dhe se do mbarojnë punë. Në orën 20:57:45 shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 0699861233 i telefonon shtetasit Orges Myftaraj ne numrin e telefonit 0038649686704 dhe e pyet se ,“he arrite”? Orgesi i përgjigjet se ,“Po mo ja me me kta jam tashi do problem a si do tja bajme i thashe une si jap dot pa o dorzu ok. Tashi do ikim te rrimë afer venit tim aty ai ti marri te niset un te vije aty te si thua?”. Shtetasi Jurgen Molla i thotë se ,“Si , si mo ca me bo edhe nje here?”, Orgesi i përgjigjet se ,“Kur ti marri në ai ne dorë unë do tja jap ktit ne dorë”. Më pas Jurgeni i thotë se ,“po merre plakun rri me te te hoteli more vlla”, ndërkaq Orgesi i thotë se ,“ po pra ate do beje”.

Në orën 21:20:46 shtetasi Orges Myftaraj me numrin e telefonit 0038649686704 i telefonon shtetasit Jurgen Molla në numrin e telefonit 0699861233 duke i thënë se ,“E tashi po presim te veje te Beni edhe pastaj mbrapa e takoi une”. Jurgeni i thotë se ,“Si e latë, si e late tash a e laste perfundimisht?”. Orges i përgjigjet se ,“Po, po do shkoje atje dhe pasanej do vije ktu direkt te mu”. Më pas Jurgeni i thotë Orgesit se ,“hajt maje kontakt pra”.

Më pas nga ora 22:23:49 deri në orën 23:15:53 shtetasi Arif Çiç me numrin e telefonit 0038649861296, shkëmben vazhdimisht mesazhe me shtetasin Jurgen Molla që po përdor numrin e telefonit 0699861233 duke diskutuar për kushtet e shkëmbimit të lëndës narkotike. Në orën 23:16:55 shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 0699861233 i dërgon shtetasit Arif Çiço ne numrin e telefonit 0038649861296 mesazh me tekst ,“Per sa me lajmeron qe ta di qa tu them ropve”. Ndërsa në orën 23:18:19 Arifi i kthn përgjigje me mesazh me tekst ,“Presim plakin un jam me xhhn dhe ben bashk”.


Më datë 29.06.2015 në orën 00:01:53 shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 0699861233 i telefonon shtetasit Orges Myftaraj në numrin e telefonit 0038649686704 duke i thënë se ,“hë mo vlla, Orgesi i përgjigjet se ,“Ja pres edhe nja gjyse ore po ashtu gjo se prape u ndrru muhabeti. U kthye prape vari trapin, po u kthye prape muhabeti eshte andej ktej s’po i japin drejtim po pres dhe nje gjyse ore une ktu”. Jurgeni i thotë se ,“pa thuji”, kurse Orgesi i përgjigjet se ,“Jo po s’ka ardhë hala po takoi edhe nje here plakun une e po ashtu gje do vije anej nqs pranojne gje”. Më pas Jurgeni e pyet Orgesin se ,“Pô a e ke ku eshte ai Çiço?”,



Orgei i përgjigjet se „Ktu me mua eshte“. Jurgeni i kaerkon orgesit tja kaloje Çiçon dhe me telefonin e Orgesit flet me pas Arifi dhe diskutojnë për kushtet e shkëmbimit“.

Në orën 08:55:42 shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 0699861233 i telefonon shtetasit Orges Myftaraj në numrin e telefonit 0038649686704 duke i thënë se „ku je“, Orgesi i përgjigjet se „E po ikim të takojmë atë të madhin të marojm punë“. Shtetasi Jurgen Molla e pyet sërish se „A folët me të“?, Orgesi i thotë se „Po folëm mbrëmë, jmei aty afër tashi, edhe t më japi ato ti japim kto“. Më pas Jurgeni e pyet sërish se „Me Benin je ti?“ dhe orgesi e aprovon. Pas kësaj shtetasi Jurgen Molla i thotë se „Po mirë pra masi te merri e shihi a jane ne rregull e masnej jepja ato“, Orgesi i thotë se „po, po“. Më pas vazhdimisht Jurgeni me numrin e telefonit 0699861233 i dërgon mesazhe dhe anasjelltas shtetasit Orges Myftaraj ne numrin e telefonit 0038649686704 duke i shpjeguar njëri tjetrit kushtet e shkëmbimit dhe menyrën e kur do bëhet shkëmbimi. Kështu në orën 09:51:58 shtetasi Orges Myftaraj me numrin e telefonit 0038649686704 i dërgon Jurgenit në numrin e telefonit 0699861233 mesazhin me tekst „ Plaku me env do ja japin ben. Un po rri pak larg, sduhet tme shofi mu env. ben mer ato dhe ja jep tjerat. Ndryshe nuk behet“. Pas kësaj Jurgeni në orën 09:56:36 i dërgon Orgesit mesazh me tekst „Po qe kshu puna ti maj lekt b masi ti mar ti shoh tam sa jan ti jap dhe lekt qe mos vonojm me ti ri diku afer sa te marohet dhe hip ne taks pastaj. Ndërsa Orgesi i thotë se „ ashtu e lam. un tani zbrita pa vajt aty. jam ne kontakt me b un“. Në orën 10:00:59 Jurgeni i dërgon Orgesit mesazh me tekst „Po h kur vjen keni lene or po porosite b qe pa i mar mos t'jap gje“. Orgesi në orën 10:51:52 i dërgon Jurgenit mesazh me tekst „Po ashtu folem. para drekes“.

Më pas Jurgeni shkëmben mesazhe edhe me Orgesin edhe me Arifin ku kërkon të informohet çpo ndodh. Në orën 11:25:58 shtetasi Jurgen Molla me numrin e teleofnit 0699861233 i telefonon shtetasit Orges Myftaraj në numrin e telefonit 0038649686704 duke i thënë „hë more vëlla“ dhe Orgesi ipërgjigjet ndër të tjera se „po pres edhe nja dy orë po su bë për dy orë po kthehemi“ dhe lë të kuptohet se ai bashkë me Benin janë pa hy një cikë pak më afër Prishtinës. Më pas në orën 11:29:30 shtetasi Jurgen Molla në numrin e telefonit 0699861233 i dërgohet mesazh nga shtetasi Arif Çiço që ka në përdorim numrin e telefonit 0038649861296 me tekst „mer viber“. Më pas shkëmbejnë mesazh me njëri tjetrin ku vazhdimisht Jurgeni i kërkon që të komunikojnë në telefon dhe në orën 11:56:45 Arifi i dërgon mesazh me tekst „ O vlla jam rug makin te mar po thom-



S E K R E T

mere te num vjeter q... nanen". Pa këtij mesazhi në orën 11:57:29 Jurgeni me numrin e telefonit 0699861233 i telefonon Arifit në numrin e telefonit 0038649807103 dhe ndër të tjera e pyet, "Ca a tu bo mo vlla?", ndërsa Arifi i përgjigjet, "Po ç'ka a tu bo ajo ashte ne... kerre q'tash jeme tu e prite mos me merre ne telefon hiq se jame rrugs tu shku me pa ate". Shtetasi Jurgen Molla i thotë se, "Hajt per nje ore ma zgjtdhe ose te nisen te vijne ktu se s'ashtu ma kjo pune q... robt". Në orën 12:42:18 shtetasi Arif Çiço me numrin e telefonit 0038649807103 i telefonon shtetasit Jurgen Molla në numrin e telefonit 0699861233 dhe ndër të tjera i thotë se, "A jenë në rregull he? Pyeti se ky po mu me çoj mesazh ai i jemi me tha po ok. Lidhu nje here lidhu se si kane qepe edhe çome mesazh hajt", kurse Jurgeni i thotë se, "Mire hajt". Më pas në orën 12:50:54 shtetasi Arif Çiço me numrin e telefonit 0038649807103 i telefonon shtetasit Jurgen Molla në numrin e telefonit 0699861233 dhe ndër të tjera i thotë se, "Ç'ka jane ata leke mangi, 7000 -jë?", kurse Jurgeni i përgjigjet se, "Nuk ka shance". Kurse Arifi vazhdon duke i thënë se, "Pa qe po me thirre ky plaki", ndërsa Jurgeni i thotë se, "Nuk ka shance po ti shihi ti numojne mire s'ka shans se ja bie une me sekonda po s'ka shans".

Në orën 12:56:21 shtetasi Orges Myftaraj, pasi i kishte dërguar mesazh Jurgeni, me numrin e telefonit 0038649686704 i telefonon Jurgenit në numrin e telefonit 0699861233 dhe ndër të tjera i thotë se, "Tani mbarova pune une u nisem ktej. Hajt mirupafshim çdo gje okej", Jurgeni e pyet, "po ku je ti, me çaje?" kurse Orgesi i përgjigjet duke i thënë se, "Une sa kalova tani ktu me taksi nga para atit, ai eshte mrapa, çdo gjë okej ka mbaru puna andej". Shtetasi Jurgen Molla i thotë se, "Po shife kur te kaloj knej o vlla", ndërsa Orgesi i thotë se, "Do rri ktu une do shofe sa te nise deri sa te ma kaloje mua o burre pa merak", kurse Jurgeni i thotë se, "hajt njofto".

Në orën 12:59:33 shtetasi Arif Çiço me numrin e telefonit 0038649807103 i telefonon shtetasit Jurgen Molla në numrin e telefonit 0699861233 dhe ndër të tjera e pyet se, "A do të më presësh mu te vije a do tja japesh makinen direkt ati shokit?", ndërsa Jurgeni i përgjigjet duke i thënë se, "Po jo more vlla prit te maroje pune njehere mos mu duke ktej". Në orën 13:00:39 Jurgeni me numrin e telefonit 0699861233, i dërgon Orgesit në numrin e telefonit 0038649686704 mesazh me tekst, "Me sqaro pak te rali kush ty ne dog", ndërsa Orgesi në orën 13:05:23 me numrin e telefonit 00447468781573 i telefonon Jurgenit dhe i sqaron rrethanat se si e kishin kthyer perseri per kontroll nga pala kosovare e kontrollit



S E K R E T

te kufirit duke i treguar se gjithshka ishte sqaruar dhe behej fjale per nje rast qe kishte pasur probleme Orgesi ne Kosove".

Në orën 13:32:59 shtetasi Arif Çiço me numrin e telefonit 0038649861296 i dërgon mesazh shtetasit Jurgen Molla në numrin e telefonit 0699861233 me tekst , "A e moren". Në orën 13:33:02 shtetasi Orges Myftaraj me numrin e telefonit 0038649686704 i dërgon mesazh shtetasit Jurgen Molla në numrin e telefonit 0699861233 me tekst , " Po. Fls aty.po pres te kaloj shoku dhe nisem". Në orën 13:33:52 Jurgeni me numrin e telefonit 0699361233, i dërgon mesazh shtetasit Orges Myftaraj ne numrin e telefonit 0038649686704 me tekst , "U afru", më pas në orën 13:34:26 i dërgon një mesazh tjetër me tekst , "Prite te kaloj e hip ne taksi e vjen posht", përsëri në orën 13:35:11 i dëron një mesazh me tekst , "Po je naj ven qe e sheh" dhe Orgesi i përgjigjet me mesazh me tekst , "po".

Në orën 13:54:43 shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 0699861233, i dërgon mesazh shtetasit Orges Myftaraj ne numrin e telefonit 0038649686704 me tekst , "He mo", Orgesi i përgjigjet duke i dërguar mesazh me tekst , "Ala", më pas në orën 14:00:17 Orgesi i dërgon Jurgenit mesazhin me tekst , "Aty afër esht".

Më datë 29.06.2015 autoritetet policore kosovare na njoftojnë në kohë reale se kamioni me targa AA090IF dhe me targë karrocierie AB R 200 ndodhej në autorstradën Prishtinë - Prizren dhe me pas ky kamion u drejtua për në Pikën e Kalimit Kufitar të Morinë. Gjithashtu nga Policia e Kosovës na u konfirmua fakti se kishte dyshime të arsyeshme se në këtë kamion ishte fshehur një sasi lënde narkotike e llojit Heroinë. Në kohë reale u bë shkëmbimi i informacionit dhe transferimi i veprimëve të vëzhgimit dhe ndjekjes së subjektit, nga shërbimet e Policisë së Kosovës tek punonjësit e Policisë të Sektorit për Narkotikët dhe Drejtorisë së Forcës Operacionale dhe Vëzhgimit në D.P.P.SH. Konkretisht nga studimi i raportit të shërbimit të datës 29.06.2015 rezulton se rreth orës 14:00 është konstatuar kamioni tip "Man" me targë AA190IF, i cili pasi kaloi kontrollin nga ana e palës kosovare, u afrua pranë P.K.K Morinë. Nga kabina e kamionit zbret drejtuesi i kamionit i cili u identifikua si shtetasi Arben Prendi. Rreth orës 14:10 minuta kamioni me targa AA190IF dhe me targë karrocierie AB R 200 futet në pikën e kontrollit kufitar shqiptar, ku nga punonjësit e policisë kufitare komunikohet me drejtuesin e kamionit dhe më pas kalon për kontroll të imtësishëm në ambientet e doganës Morinë. Gjatë kontrollit të ushtruar në bashkëpunim me shërbimet e policisë kufitare në kabinën e kamionit në pjesën e pasme të sediles së pasagjerit, poshtë krevatit me të cilin janë pajisur këto





SEKRET

automjete, u gjet një valixhe ngjyrë lejla brenda së cilës gjendeshin dy thasë të zinj plastikë të tejdukshme të mbushura me material në trajtë pluhuri, i dyshuar si lëndë narkotike e llojit heroinë. Njëri thes i zi kishte 126 qese të mbushura me material në trajtë pluhuri i dyshuar si lëndë narkotike e llojit heroinë, thesi tjetër i zi kishte 50 qese të tejdukshme të mbushura me material në trajtë pluhuri e dyshuar si lëndë narkotike e llojit heroinë.

Shtetasi Andrea Prendi bashkë me lëndën narkotike të dyshuar si heroinë, u morën nga shërbimet e policisë kufitare bashkë me ato të Sektorit për Narkotikët dhe Trafikët të D.P.Q Kukës, për kryerjen e veprimeve të tjera proceduriale.

Në orën 14:19:01 shtetasi Jurgen Molla duke mos e ditur akoma çfarë ka ndodhur me shtetasin Arben Prendi dhe lëndën narkotike të llojit heroinë që Beni po transportonte, me numrin e telefonit 0699861233, i dërgon mesazh shtetasit Orges Myftaraj ne numrin e telefonit 0038649686704 me tekst „Fola me me te ti ose fol dhe i her prite zot me u ba gja jan te arift makinat porosite me lezet vlla“, ndërsa në orën 14:20:34 Orgesi i kthen pergjigje me mesazh me tekst „Te presim dhe pak vlla“, kurse ne orën 14:21:24 Jurgeni i dërgon sërish mesazh Orgesit me tekst „Ok mo po porosite te num kosov a ka“.

Në orënv 15:14:31 shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 0692411117 i telefonon të vëllait Tanit në numrin e telefonit 0692072502 dhe ndër të tjeraj i thotë se „Ik iher leviz ik der te shpia meri ato lek ça jan n shpi mbaji, meri lekt çoi n banke, lviz meri ato lek çoi te banka qe jan te shpia“. Tani i përgjigjet „po“, Ndërsa Jurgeni vazhdon „e vjen Lola se a problem“, kurse Tani e pyet se „hajt ku je ti“, ndërkaq Jurgeni i përgjigjet se „po lviz un“.

Në orën 15:16:59 shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 0692411117 i telefonon shtetasit Orges Myftaraj në numrin e telefonit 0699409888 dhe ndër të tjera i thotë se „O leviz ... se e kan kap ka ...in“, kurse Orgesi i thotë se „Ouu“, Jurgeni i thotë se „po“, kurse Orgesi i thotë se „hajt se pres telefonin kteja un hajt“, ndërsa Jurgeni i thotë se „preja telefonat, ato tjerat priti“.

Në orën 15:17:52 shtetasi Jurgen Molla në numrin e telefonit 0692411117 i telefonon i vëllai Tanit me numrin e telefonit 0692072502 duke e pyetur „ku je ti?“, kurse Jurgeni i përgjigjet se „pö leviz diku un pö shko der te shpia ti meri çoi n banke ato t pakten ose maji diku tjetër, Tani i kerkon ta takoje ndërsa Jurgeni i thotë se po lviz un se po t them un ku me u taku ma von po hajt t çoj un fjal per dike“.



SEKRET

SEKRET

Në orën 15:20:13 shtetasi Orges Myftaraj me numrin e telefonit 0699409888, i telefonon shtetasit Jurgen Molla në numrin e telefonit 0692411117 dhe ndër të tjera e pyet se „po un nga t shkoj?“, ndërsa Jurgeni i përgjigjet se „Ik diku ndalu diku iher sa t mar gja vesht“.

Mbas veprimeve të koordinuara në kohë reale, nga ana e apunonjësve të policisë kufitare në P.K.K Morinë më datë 29.06.2015, ora 17.00, u arrestua në flagrancë shtetasi Arben Prendi i biri i Ndue dhe i Tringë i datëlindjes 11.01.1972, banues në Lezhë, me arsim 8 klasë. Këtij shtetasi në kamionin me targa AA 090 IF që ai drejtonte, në PKK, Morinë, në kabinën e mjetit, iu gjet dhe bllokuan me cilësinë e provës materiale 15 kg e 224 gr. lëndë narkotike e llojit Heroinë. Materialet në lidhje me këtë shtetas u dërguan pranë Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë për veprën penale të „Trafikim të lëndëve narkotike“ parashikuar nga neni 283/a/2 të Kodit Penal.

Gjithashtu nga studimi i materialeve proceduriale rezulton se shtetasi Orges Myftaraj i ka kërkuar shtetasit „Klaudio Veizaj“ që të shkojë më datë 29.06.2015 ta marrë në P.K.K Morinë. Ndërkohë që shtetasi Arif Çiço me një shtetasin Enver Kurtulus që i thërrasin „plaku“ kanë siguruar lëndën narkotike të llojit heroinë.

Sa mësipër nga procesverbalet e transkriptimit të bisedave, raportet e vëzhgimit dhe procesverbalet e sekuestrimit rezulton se janë konsumuar elementët e veprave penale të „Trafikimit të lëndëve narkotike“ e kryer në bashkëpunim. Konkretisht gjatë muajit Qershor 2015, shtetasit Jurgen Molla, Arif Çiço, Abubekir Tuncdemir, kanë realizuar një sërë takimesh në Kosovë dhe në Shqipëri, në funksion të arritjes së marrëveshjes për trafikimin e një sasi heroine, e cila do të sigurohej nga shtetasi Abubekir Tuncdemir, ndërsa shtetasi Jurgen Molla sëbashku me shtetasin Anest Koromani ishte blerësi i heroinës.

Pas arritjes së marrëveshjes, ku pala kosovare kërkonte garancinë e pagesës nga shtetasi Jurgen Molla, ky i fundit më datë 27.06.2015 dyshohet se ka dërguar në Prizren, Kosovë, lidhjen e tij më të besuar shtetasin Orges Myftarajin me një sasi të konsiderueshme rreth 230.000 €.

Njëkohësisht, po më datë 27.06.2015, Jurgeni ka takuar në Patok shtetasin Arben Ndue Prendi, ku dyshohet se i ka dhënë dhe shumën prej 8000 €, si pagesë për transportin e ngarkesës së Heroinës. Shtetasi Arben Prendi po në këtë ditë është nisur për në Kosovë me kamionin tip MAN, me targë AA090IF.



SEKRET

SEKRET

Nga data 27-29.06.2015, nga bisedat midis shtetasve të mësipërme, rezultonte fakti se heroina nëodhej në afërsi të Prishtinës, ku ishte e magazinuar dhe për këtë vend kishin dijeni shtetasit turq dhe kosovarë Abubekir Tuncdemir, Enver Kurtuluş, Arif Çiço.

Gjithashtu nga kontaktet telefonike u kuptua se shtetasi Jurgen Molla ka pasur një borxh për të paguar një transport të mëparshëm kundrejt shtetasit Enver Kurtuluş, i cili fillimisht nuk ishte dakord për t'i dhënë heroinën, por më pas më datë 29.06.2015, shtetasit Abubekir Tuncdemir dhe Enver Kurtuluş, në një valixhe ja dorëzojnë ngarkesën e heroinës transportuesit Arben Prendi në një vend në Kosovë.

Më datë 29.06.2015, në PKKK Morinë të Kukësit u arrestua në flagrancë shtetasi Arben Ndue Prendi, si dhe u sekuestrua një sasi prej 15.420 kg heroinë.

Shtetasi Jurgen Molla për një periudhë kohore i ka mbajtur telefonat të mbyllur ose fliste shumë rrallë. Ndërkohë nga studimi i raportit të shërbimit të datës 22.08.2015 shtetasi Arif Çiço është konstatuar në vendin e quajtur Bar restorant "guri" duke zbritur nga automjeti me targa 04 - 710 -es. Në këtë vend rreth orës 17:45 është konstatuar dhe mjeti me targa AA293IY, të cilin ia ka dërguar shtetasi Jurgen Molla për ta marrë dhe për ta çuar në vendin ku do takohen sëbashku. Fillimisht shtetasi Arif Çiço shkon me mjetin me targa AA293IY në drejtim të restorant "Halili" që ndodhet ngjitur me Bar Restorant, Guri. Rreth orës 18:10, shtetasi Arif Çiço sëbashku me një shtetas tjetër hipin në automjetin me targa AA293IY dhe lëvizin në drejtim të Laçit, tek mbikalimi i Laçit kthehen djathtas në drejtim të Patokut. Më pas shtetasi Arif Çiç shkon në një lokal në zonën e Patokut dhe aty është takuar dhe me shtetasin Jurgen Molla.

Nga studimi i raportit të shërbimit 01.09.2015 rezulton se shtetasi Jurgen Molla është konstatuar në spitalin "Hygeia", duke përdorur mjetin me traga AA111JG.

Nga studimi i raportit të shërbimit 10.09.2015, në orën 22:30 është konstatuar automjeti me targa AA111JG i cili ka ndaluar në rrugën "Teodor Keko", përpara local "Sydney" që ndodhet në unëzën e re, nga ky automjet zbrit shtetasi Jurgen Molla pasi rezulton se kishte lënë takim më parë dhe takohet me një shtetas të moshës rreth 25 vjeç, me flokë të shkurtra, i cili ishte drejtuesi i mjetit AA593JG. Ky shtetas nga përgjimi i bisedave telefonike përdorte numrin e telefonit 00355695144403, kurse Jurgeni numrin e telefonit 0692887906. Nga studimi i proces verbaleve të datave 10.09.2015, 11.09.2015, 12.09.2015 për përgjimin e telekomunikimeve të numrave të telefonit 00355695144403 dhe 0692887906 rezulton se shtetasi Jurgen Molla po kërkonte që ti kryente trafikimin



SEKRET

e një sasive lënde narkotike shtetasit Shyqyr Kotorri i cili përdorte numrin e telefonit 00355695144403. Lënda narkotike po dërgohej në Selanik nga dy shtetas turq. Trafikimin e kësaj lënde narkotike e organizoi shtetasi Arif Çiço me shtetasin i cili thërritet "Plaki". Lënda narkotike do të shkonte në Greqi për llogari të shtetasit Anesti Koromani dhe ndërmjetësimin po e bënte shtetasi Jurgen Molla.

Më datë 11.09.2015 në orën 10:15:22 shtetasi i cili përdorte numrin e telefonit 00355695144403 i telefonoi një shtetaseje e cila përdorte numrin e telefonit 0684082290 e cila thërritej Vilma. Shtetasi që po përdorte numrin e telefonit 00355695144403 ndër të tjera i thotë Vilës se "Çkemi Shyqua jam Kotorri" në këtë mënyrë vetidentifikohet.

Nga studimi i raportit të shërbimit të datës 11.09.2015 rezulton se rreth orës 09:20 në vendin e quajtur kompleksi "Molla" në afërsi të Bar Kafe Enigma, para lokalit ishin të parkuar automjetet e markës Benz Mercedes, ngjyrë gri me targa AA166LM, automjeti i markës Benz Mercedes ML, me ngjyrë blu, me targa AA111JG dhe autojmeti i markës BMË X6, ngjyrë gri me targa AA400LU. Në orën 09:50 ka ardhur në këtë vend dhe shtetasi Anest Koromani me mjetin me targa AA221IS, i cili ishte i shoqëruar me një shtetas të moshës rreth 35 vjeç dhe një shtetase femër 28-30 vjeç. Shtetasi Anest Koromani është futur në hyrjen e pallatit ngjitur me Bar Kafe Enigma. Në orën 09:55 para lokalit ka ndaluar automjeti i markës Audi Q 7, ngjyrë gri, me targa AA400KY, nga ku ka zbritur një shtetas i cili është futur në ambientet e kompleksit. Nga përgjimet ka rezultuar se shtetasi Anest Koromani është takuar me shtetasin Jurgen Molla. Takimi ka dyshime të arsyeshme se është bërë në funksion të trafikimit të një sasive lënde narkotike të llojit heroinë në Greqi.

Më datë 11:09:2015 shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 00355692887906 i dërgon një mesazh shtetasit Shyqyr Kotorri në numrin e telefonit 00355695144403 me tekst "O shok po gjete dike ka mumsi te mar me shumie beton seq folem se sa me njoftun". Në orën 21:30 shtetasi Shyqyr Kotorri i kthen përgjigje duke i dërguar mesazh me tekst "Po ikën vella dhe nesor kur te jet nesor atje do te jap tel". Më pas në orën 21:38:43 shtetasi Shyqyri Kotorri i dërgon një mesazh tjetër me tekst "O vlla shift e jen ustallaret gati nesor se do ver pompa ne mengjes". Në orën 21:45:56 Jurgeni i kthen përgjigje me mesazh me tekst "Gati i ke ti veq me qo num e pompistit ta marim ne te d he ok".



Më datë 11.09.2015 në orën 01:44:47 shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 00355692411116, i dërgon një mesazh një shtetasi i cili përdor numrin e telefonit 00355693026969 me tekst " Mir Molla jam po kush a me pun aty e ke num ed sokolit ma qo pak", kështu që vetidentifikohet".

Më datë 12.09.2015 dhe 13.09.2015 shtetasi Jurgen Molla shkëmben mesazhe me shtetasin Shyqyr Kotorri dhe bisedojne në telefon me njëri tjetrin, ku shtetasi Jurgen Molla komunikon edhe me numrin e telefonit 00355692887906 edhe numrin e telefonit 00355692411116. Nga bisedat dhe mesazhet kuptohet që po organizojne punën për trafikimin e një sasive lënde narkotike të llojit heroinë për në Greqi. Bisedat behen të koduara duke përdorur "hedhjen e betonit" me të cilën kuptohet lënda narkotike. Konkretisht ndër bisedat e tjera më datë 13.09.2015 në orën 11:14:48 shtetasi Shyqyr Kotorri me numrin e telefonit 0695144403 i telefonon shtetasit Jurgen Molla në numrin e telefonit 00355692887906 dhe ndër të tjera i thotë se " bëre nanji telefon", Jurgeni i thotë se "a jan lidh ata di gjaa", Shyqua i thotë se "ja ja të flas çik un dhe t them", kusre Jurgeni i thotë se "pyt iher e m kallzo". Menjëherë pas kësaj telefonate në orën 11:26:34 Shyqua në numrin e telefonit 0695144403 telefonohet nga një shtetas që ka në përdorim numrin e telefonit 00306942678596 dhe ndër të tjera shtetasi që ka në përdorim numrin grek i thotë Shyqos së " E po vajti ora nje o ça bejn ata". Shtetasi Shyqyri menjëherë pas kësaj telefonate në orën 11:44:06 me numrin e telefonit 0695144403 i telefonon shtetasit Jurgen Molla në numrin e telefonit 00355692887906 duke i thënë ndër të tjera se "beji nonj telefon atyre ustallarëve o burr jan puntorët atje". Më pas shtetasi Shyqyr Kotorri lidhet sërish me shtetasin që ka në përdorim numrin e telefonit 00306942678596 dhe shtetasin Jurgen Molla dhe diskutojne se si mund te lidhen shtetasit qe do çojne betonin me ustallaret qe presin betonin, ku lene te kuptohet se duhet te takohen shtetasit qe kane çuar lenden narkotike me ata qe do ta marrin.

Më datë 14.09.2015 , në orën 12:55:25 shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 0692411116 i telefonon një shtetaseje e cila thërritet Katrinë dhe ka në përdorim numrin e telefonit "00393393523694" duke i thënë ndër të tjera se " Alo Katrinë si je, ça ke ba a je nana e Benit". Shtetasja i përgjigjet "po", ndërsa Jurgeni vazhdon duke i thënë se "Un jam djali i Femisë që ke ken një dit ke taku Feminë ktu" dhe duke qënë se Katrina nuk e dëgjon mirë i thotë se "Djali i Femisë, djali i Femisë, nana e Benit, djali i Femi Mollës". Edhe këtu shtetasi Jurgen Molla vetëidentifikohet. Më pas nga studimi i procesverbaleve të



S E K R E T

përgjimit të telekomunikimeve midis shtetasit Jurgen Molla me numrin e telefonit 0692411116 dhe shtetases që thërritet Katrina që po përdor numrin e telefonit 00393393523694 rezulton se shtetasi Jurgen Molla i kërkon ta takojë shtetasen që thërritet Katrina në mënyrë që të dikutojnë për ta ndihmuar shtetasin Arben Prendi me gjithshka që i nevojitet. Gjithashut Jurgeni i tregon se numrin ia ka dhënë Koli (Koli thërritet drejtuesi i mjetitv me targa AA999BU) dhe i kërkon që bashkëshortja e Benit të bëjë kujdes edhe të mos e pengojë Jurgenin në këtë moment.

Nga ana jone eshte bere shkembimi i informacionit me autoritetet ligjzbatuese greke duke iu derguar dhe numrin e telefonit grek te perfshire ne kete procedim si dhe te dhena te tjera te nevojshme. Nga ana e autoriteteve greke jeni njoftuar se më datë 18.09.2015 në kuadër të procedimit nr. 81 viti 2015 për te cilin ne ju kishim dërguar informacion, janë arrestuar në Selanik/Greqi me 5 kg heroinë, shtetasit turq Erol BILIR dhe Songul ERKEK.

Duke u nisur nga sa mësipër rezulton se dërgimin e sasisë prej 5 kg heroinë në Greqi e ka organizuar shtetasi Arif Çiço dhe shtetasi që thërritet "Plaki" duke përdorur si transportues shtetasit turq Erol BILIR dhe Songul ERKEK. Në Greqi për llogari të shtetasit Jurgen Molla po prisnin të merrnin lëndën narkotike lidhjet shoqerore të shtetasit Shyqyr Kotorri.

Më datë 20.09.2015 në orën 15:09:32 shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 00355692411116 i ka dërguar mesazh një shtetasi i cili ka në përdorim numrin e telefonit 0031615402842 me tekst "Ehe mos pyt ma ma mrapsht qe ne qershor ska ma ti mir ja ke kalu ky a num yt".

Më datë 21.09.2015 shtetasi Arif Çiço sëbashku me një shettas turk që dyshohet të ketë qënë shtetasi Mehmet Kulug, dyshohet se është takuar me shettasin Nuredin Nazraj dhe Lulzim Qorri ne vendin e quajtur karburant alpet ne Lushnje. Takimi dyshohet të jetë bërë në funksion të trafikimit të një sasive lënde narkotike të llojit kanabis sativa nga Shqipëria në Kosovë.

Nga veprimet e vëzhgimit të fshehtë të kryer më datë 27.10.2015 në orën 19:55' janë konstatuar të ulur tek Bar Restorant "Vila e Art" tre persona në ambientet e jashtme. Personi i parë i moshës rreth 40 vjeç, me flokë të shkurtra, pak të thinjura, veshur me xhaketë ngjyrë të zezë, pantallona xhins. Personi i dytë i moshës rreth 38-40 vjeç, qeros, i shkurtër rreth 165 cm, veshur me bluzë ngjyrë gri, pantallona xhins. Personi i tretë i moshës rreth 35 vjeç, me flokë të shkurtra, i gjatë rreth 180 cm, i shëndoshë, i veshur me xhup të zi, pantallona të



S E K R E T

zeza. Personi i moshës rreth 40 vjeç ndahet nga personat e tjerë me të cilët ishte ulur dhe është larguar me automjetin e markës BMË X5, me targa AA999BU. Ndërsa dy personat e tjerë 35 dhe 38-40 vjeç pasi dalin nga lokali, ndahen dhe personi i moshës 35 vjeç largohet me automjetin e markës Mercede Benz, me ngjyrë gri me targa AA566IL.

Nga veprimet e vëzhgimit të fshehtë të kryer më datë 30.10.2015 në orën 15:50' është konstatuar e parkuar në parking përballë Prokurorisë për Krimet e Rënda automjeti me targa AA999BU. Në orën 16:08' në këtë automjet hipin tre persona, personi i parë drejtuesi i moshës rreth 40 vjeç, me flokë të shkurtra, pak të thinjura, veshur me këmishë me ngjyrë të bardhë, kostum ngjyrë të zi. Personi i dytë i cili u ul në vendin e parë të pasagjerit i moshës rreth 45 vjeç, me flokë të shkurtra, veshur me këmishë ngjyrë të bardhë dhe me kostum me ngjyrë blu e hapur. Personi i tretë që u ul mbrapa në automjet i moshës rreth 38 vjeç, me flokë të shkurtra, i veshur me këmishë me kuadrata të bardha, pantallona xhins dhe lëvizin në drejtim të rrugës Don Bosko. Në rrugën "Hajredin Shtino" zona Don Boskos nga automjeti ka zbritur drejtuesi dhe pasagjeri i ulur në vendin e parë i moshës rreth 45 vjeç të cilët kanë qëndruar në këmbë duke biseduar. Pas disa minutash ka zbritur edhe pasagjeri që ishte ulur mbrapa automjetit, i moshës rreth 38 vjeç. Të tre këto persona janë takuar me një person të moshës rreth 30 vjeç, i qethur shkurt, i shëndoshë, veshur me xhup të zi, pantallona të zeza. Personi i moshës rreth 40 vjeç ka hapur bagazhin e automjetit ku ka futur diçka dhe ka qëndruar duke biseduar me personat e tjerë. Personi i moshës rreth 30 vjeç pasi është ndarë me personat e lartpërmëndur, ka ecur në këmbë në drejtim të rrugës "Hajredin Shtino", ndërsa tre personat janë larguar me automjetin me targa AA999BU.

Nga veprimet e vëzhgimit të fshehtë të kryer më datë 31.10.2015 në orën 12:55' është konstatuar duke ndaluar pranë Q.T.U në Fier, automjeti i markës Fiat Stilo , me targa AA792HL, me drejtues shtetasi i njohur me emrin Danjel, pasagjer i ulur në vendin e parë ka qënë personi i njohur me emrin Izmir dhe një person tjetër i moshës rreth 35 vjeç, me flokë të zeza, veshur me bluzë me ngjyrë të zezë i ulur mbrapa. Nga automjeti ka zbritur Izmir i cili ka biseduar në telefon dhe pranë vjen një mjet i markës Opel, ngjyrë e bardhë, me targa AA053FH dhe Izmiri hipën tek automjeti Opel nga mbrapa si pasagjer. Më pas të dy automjetet me targa AA792HL dhe AA053FH, kanë lëvizur në drejtim të autostradës Levan-Tepelenë. Më pas dy automjetet janë kthyer në fshatin Vreshtas-Cakran, të cilët



SEKRET

kanë ndaluar njëri pas tjetrit në hyrje të fshatit. Pasi kanë zbritur të gjithë nga mjetet kanë biseduar në këmbë dhe me pas Izmiri, Dilo dhe drejtuesi i mjetit me targa AA053FH janë larguar me mjetin dhe janë ulur tek bar restorant "Cakrani", ndërsa Danjeli sëbashku me pasagjerin personin e moshës rreth 35 vjeç, kanë lëvizur me mjet drejt fshatit Cakran.

Në orën 13:45 mjeti me targa AA792HL, ka dalë nga fshati Cakran dhe pranë bar restorant "Cakrani" ka zbritur pasagjeri i moshës rreth 35 vjeç i cili ka hipur në mjetin me targa AA053FH ku ishte Dilo dhe Izmiri dhe janë larguar në drejtim të Levanit-Fier. Pasi kanë shkuar në Fier në një rrugic pranë QTU Fier kanë zbritur nga mjeti me targa AA792HL dhe kanë hipur në mjetin tip Mercedes Benz me targa AA336JC ku drejtues ka qënë Dilo pasagjer Izmiri dhe personi i moshës rreth 35 vjeç. Mjeti ka vazhduar rrugën në drejtim të Durrësit ku në afërsi të "Bar Restorant Tirana" ka ndaluar mjeti dhe kanë zbritur Izmiri dhe personi i moshës rreth 35 vjeç, ndërsa mjeti vazhdoi rrugën dhe ka ndaluar tek rreth rrotullimi Kavaleshencës ku në mjet ka hipur një femër e moshës rreth 50 vjeç, me flok të shkurtra dhe kanë lëvizur drejt Durrësit.

Në orën 19:15' është konstatuar mjeti tip Passat, ngjyrë gri, me targa AA871HO, i parkuar para Bar Restorant "Syla" pranë P.K.K Morinë. Në orën 20:00' ka zbritur djertuesi i mjetit dhe ka hyrë në lokal "Syla" ku ka qëndruar 20' dhe me pas ka dalë dhe është takuar me dy persona të moshës rreth 25-30 vjeç, ka biseduar 5' në këmbë dhe kanë hyrë të tre në lokal "Syla". Në orën 20:40' drejtuesi mjetit AA871HO hipi në mjet dhe lëvizi drejt Kukësit.

Nga studimi i raporteve të shërbimit të datave 01.11.2015, 04.11.2015 dhe përgjimet telefonike të bëra në këto data rezulton se shtetasit Nuredin Nazëraj, nip i vet dhe shtetasi Lulzim Qorri merren me sigurimin e lëndës narkotike të llojit kanabis sativa dhe shpërndajnë lëndë narkotike të llojeve të ndryshme.

Nga ndjekja intensive e shtetasit Nuredin Nazëraj dhe bashkëpunëtorëve, pasë dhënies të informacionit në kohë reale më datë 30.11.2015 në Pogradec u kap një shtetas me një sasi prej 5 kg e 108.4 grame lende narkotike kanabis sativa. Në këtë rast është arrestuar shtetasi Viktor Behaj. Ky shtetas ishte duke përdorur mjetin e shtetasit Nuredin Nazëraj.

Nga studimi i 03.11.2015 shtetasi që përdor numrin e telefonit 0694290448, telefonohet nga shtetasi që përdor numrin e telefonit 0694434473 ky i fundit i thotë se "me u paraqite në gjyq a të shkruajmë ndonje gje të re prokura nga mrapa. Të shkruaj e nderuara z/gjyqtare nuk kam mundësi të paraqitem në gjyq



SEKRET



a gjo". Shtetasi që përdor numrin e telefonit 0694290448 I thotë se "Po more po nuk kam mundesi te paraqitem ne gjyqe ja le te gjithë mbrojtjen time liogjore me te drejta te plota av/ Sokol Tahiraj edhe Arber Hoxhes. Shtetasi që përdor numrin e telefonit 0694434473 I thotë se "Siç e kiam shkruajtur ne prokure e". Ndërsa tjetri I thotë se "po", "kshtu qe edhe te ajo refuzimi ta shkruaj te njejtën gje me kupton". Tjetri I thotë "Ok".

Nga studimi i raportit të shërbimit të datës 05.11.2015 rezulton se automjeti BMË X5, me ngjyrë të zezë, me trga AA999BU është konstatuar i parkuar në pranë Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë. Tek automjeti me targa AA999BU në orën 11:30 afrohet dhe hipën një shtetas rreth 40 vjeç, me fokë të shkurtra të thinjura, veshur me këmishë me ngjyrë të bardhë, pantallona të zeza sëbashku me një shtetas tjetër rreth 35 - 40 vjeç me flokë të shkurtra, veshur me këmishë ngjyrë të bardhë, kostum gri. Automjeti ka vazhduar rrugën nga rruga Asim Vokshi, në bulevardin Zogu i I".

Nga komunikimet me qëndën e përgjimeve dhe pas studimit të raporteve të shërbimit ka dyshime të arsyeshme se shtetasi Jurgen Molla me ndërmjetësimin e dy shtetasve që hipën në mjetin me targa AA999BU, nga të cilët njëri është drejtuesi i mjetit dhe ka rolin e sekserit, dhe tjetri është avokati i shtetasit Arben Prendi i cili thërritet Arbër, po kërkonin që të korruptonion zyrtarë të Gjykatës së Shkallës së parë për Krimë të Rënda Tiranë me qëllim pranimin e gjykimit të shkurtuar për shtetasin Arben Prendi për rastin e sekustrimit të 15 kg lëndë narkotike të llojit heroinë në P.K.K Morinë. Këtë gjë ka dyshime të asyeshme se shtetasit e mësipërm nuk e kanë arritur sepse Gjykata e Shkallës së Parë për Krime Të Rënda ka vendosur që të mosë pranohet gjykimi i shkurtuar për çëshjten në ngarkim të shtetasit Arben Prendi.

Më datë 30.11.2015 shtetasi i cili thërritet "Dilo" në numrin e telefonit 0699780186 telefonohet nga shtetasi i cili thërritet "Luli" me numrin e telefonit 0685760175 dhe e pyet se "ku ishte"? Dilo i përgjigjet se "ika unë vetë pilot". Shtetasi i cili thërritet "Luli" i thotë "shumë nurrë ke bërë". Më pas shtetasin i cili thërritet "Dilo" në numrin e telefonit 0699780186 e telefonon një shtetas i cili disponon numrin e telefonit 0693222050 dhe e pyet se deri ku ishte, ndërkohë që dilo i thotë se është te "Lake Park" dhe e lënë të takohen në rrugë. Nga kontrolli i ushtruar në mjetin me AA336JC është gjetur dhe sekuestruar 5 kg dhe 108.4 gram lëndë narkotike e dyshuar si kanabis sativa. Pasi kapet lënda narkotike



shtetasi i cili thërritet "Dilo" me numrin e telefonit 0699780186 i telefonon shtetasit që thërritet "Luli" në numrat e telefonit 0685760175 dhe më pas në numrin 0693356943 dhe i thotë që "keq puna merri ata të shtëpisë". Pas kësaj telefonate shtetasi që thërritet "Luli" merr në telefon bashkëshorten e "Dilos" në numrin e telefonit 0692416560 duke i thënë se "pastroje shtëpinë, keq puna". Bashkëshortja e "Dilos" e pyet "E kapën"? por Luli nuk e vazhdon më bisedën. Më pas shtetasja e cila thërritet "Shqiponja" i telefonon Dilos dhe ky i fundit i thotë "keq puna" dhe më pas e fik telefonin. Ndërkohë shtetasi i cili thërritet "Luli" i ka telefonuar dhe një shtetas i cili dyshohet të jetë njëri nga djemtë e "Dilos" dhe përdor numrin e telefonit 0693477194 dhe e lenë të takohen tek vendi i Lulit. Shtetasin që thërritet "Luli" e ka telefonuar dhe shtetasi i cili thërritet "Landi Lleshi" me numrin e telefonit 0692028588 dhe i thotë se "Hë mo iku ai andej", ndërkohë që shtetasi i cili thërritet "Luli" i thotë se "Lëre se nuk janë punët mirë po hajde të takohemi" dhe e lenë të takohen tek vendi i quajtur "Sufllaqet" tek vendi i Lulit.

Më datë 30.11.2015 në orën 11:20 në të hyrë të qytetit të Pogradecit në vendin e quajtur "Enkelane" gjate kontrollit të ushtruar nga ana e punojësve të policisë në këtë pikë kontrolli në automjetin e markes "Mercedez Benz" me targa AA 336JC që drejtohej nga shtetasi Viktor Behaj është gjetur në vendin e gomes rezerve një sasi prej 5 kg 108.4 gram, bime të dyshuar bime narkotike të llojit "Cannabis Sativa". Për këtë është arrestuar shtetasi Viktor Behaj i biri i Haxhi dhe i Lejmone lindur me 05.12.1967 në Fier, gjinia Mashkull kombësia, Shqiptare, shtetësia, Shqiptare, arsimi 8 Klase, profesioni shofer gjendja familjar i divorcuar, banues në lagjia "11 Janari" qyteti Fierit, tel "0693295632" me gjendje gjyqesore i pa denuar me parë, mbajtës i dokumentit identifikues lëternjoftim me nr "032014650".

Më datë 01.12.2015 shtetasi i cili thërritet Luli ka komunikuar me një shtetas i cili thërritet "Olti" që përdor numrin e telefonit 0696685888 dhe ky i fundit i thotë se "ja kalova nga portokallet për nga Vlora".

Nga studimi i raportit të shërbimit të datës 02.12.2015 rezulton se pranë rreth rrotullimit të fshatit Grabian, në autostradën Lushnjë Rrogozhinë, konkretisht pranë Fast Food "Tre VËLLEZËRIT", në orën 18:05 është konstatuar shtetasi i njohur si Roland Lleshi, bashkë me një shtetas tjetër i cili ishte rreth 28 vjeç dhe të dy zbritën nga autojveti me targa AA600MA dhe janë futurë në ambientet e Fast Food "TRE VËLLEZËRIT", ku po i prisnin të ulur në



tavolinë dy shtetas të tjerë, shtetasi Lulzim Qorri dhe një shtetas tjetër rreth 55 vjeç me flokë të thinjura. Aty kanë ndenjur 30 minuta dhe në orën 18:35 shtetasi Roland Lleshi me shtetasin 28 vjeçar kanë dalë nga lokali dhe ckanë hipur në automjetin me targa AA600MA dhe kanë vazhduar rrugën për në Lushnjë. Ndërsa shtetasi Lulzim Qorri me shtetasin 55 vjeçar dolën nga Fast Food "TRE VËLLEZËRIT" dhe kanë vazhduar lëvizjen në çkëmbë në rrugën që të çon në Fshatin Grabian

*Nga sa mësipër dhe rezulton se shtetasi Lulzim Qorri sëbashku me shtetasit Nuredin Nazëraj, Roland Lleshi ose Denis Isuf Sinameta dhe shtetasi Keli i cili është shtetasi që ka emrin Elton Nazëraj dhe i thone me pseudonimin "Olti" dhe është djali i xhaxhajt të shtetasit Nuedin Nazërajt që i thonë Dilo (këto kanë rezultuar nga rasti në fjalë nga materialet referuar pranë Prekurorisë së Rrethit Gjyqësor Pogradec) kanë organizuar trafikimin e kësaj sasive lëndë narkotike nga Fieri me destinacion final Greqinë. Lëndën narkotike do ta trafikonin sëbashku me një lidhjen e tyre shoqërore nga Korça, shtetas ky i paidentifikuar".*

Më datë 10.12.2015, në orën 18:02:59 shtetasi Jurgen Molla kontaktohet nga Tringa (Katerina) Prendi me numrin e telefonit 00393393523694. Gjatë bisedës Jurgeni i përsërit disa herë se i ka vënë punët në terezi, si dhe e porosit që t'u thotë personave të tretë të mos flasin, pasi prishin punë. Tringa i ka treguar Jurgenit se e ka telefonuar i biri, Arben Prendi, personi nga burgu, i cili i ka thënë se i ka humbur shpresat dhe e ka porositur, që t'i thotë Jurgenit të mos e lërë në burg për lekë dhe se deri tani nuk është dhënë asnjë lek. Jurgeni i thotë se nuk mund t'i tregojë se ku po i jep lekët, pasi i del fjala, por i thotë se lekë janë dhënë dhe po vazhdojnë të jepen përditë. I biri i ka thënë Tringës, se po rri në burg, ngaqë nuk janë dhënë lekë. Jurgeni fajëson të shoqen e Arbenit, e cila ka bërë pazare të mëdha. Jurgeni i përsërit, se ka dhënë lekë dhe personat që i kanë marrë, nuk e pranojnë, pasi "edhe muret kanë veshë". Tringa i betohet Jurgenit se do t'ia kthejë të gjitha lekët dhe Jurgeni e siguron se çështja do të shkojë në Apel dhe se Arbeni do të lirohet shumë shpejt.

Në vijim të kësaj bisede, Jurgeni i thotë se: "...Një që ka qenë, që ka pas prish punë aty ku është ai, një X prokuror që ka pas fut atë, e kanë shkarkuar sot. Janë dhënë lekë që është shkarkuar, nuk po të them më gjatë!...". Tringa shpreh habi. Jurgeni vijon duke thënë: "...E kanë heq nga aty e kanë dërguar në Shkodër,



SEKRET

prej këtyre punëve...". Tringa e pyet: "...E keni pas kundra atë?...". Jurgeni përgjigjet: "...Po, një legen, që e kemi pas kundër. Më gjatë nuk flas dot. Çoja me amanet, thuaji për punë lekësh...". Tringa i thotë: "...Me amanet ia çoj, faleminderit prej teje, nesër do të them çfarë më ka thënë...". Jurgeni përfundon bisedën duke i thënë: "...Thuaji, për lekë nuk rri brenda sa të jem unë gjallë...". Dyskohet se prokurori të cilit i referohet shtetasi Jurgen Molla, është prokurori Anton Martini.

Nga studimi i raportit të shërbimit të datës 16.12.2015 rezulton se vërshtë konstatuar shtetasi Jurgen Molla ose Miri i cili ka qënë i ulur në ambientet e brendshme të lokal Bar Kafe "VERTU" në tavolinë me katgër persona të tjerë. Gjithashu është konstatuar i parkuar edhe mjetei BMË X6 , me ngjyrë të bardhë me traga AA254MR.

Në muajin mars 2016, shtetasit Jurgen Molla, Arif Çiço, Mehmet Kulug, Ihsan Olmez, Blerim Ukimeraj kanë zhvilluar takime fizike dhe kontakte telefonike me njëri tjetrin në funksion të arritjes së sigurimit të një sasive heroine dhe trafikimin e saj për në Shqipëri.

Në këtë rast, sipas informacionit të siguruar në rrugë operative, shtetasi Jurgen Molla kishte dalë garant për t'i siguruar një sasi lënde narkotike të llojit heroinë shtetasit Anesti Koromani. Këtë sasi heroine do ta siguronte shtetasi turk Mehmet Kulug, i kthyer nga Franca, ku atje i është goditur një pjesë e rrjetit.

**Informacion i përftuar nga puna operative gjurmuese:**

Më datë 14.03.2016, shtetasi Jurgen Molla i shoqëruar nga shtetasi Anesti Koromani janë takuar në Shqipëri me Arif Çiçon, i cili ka qënë i shoqëruar nga shtetasi kosovar Blerim Ukimeraj, si dhe dy shtetasit turq, Ihsan Olmez e Mehmet Kulug. Në këtë takim është diskutuar për mënyrën e kryerjes së finalizimit të blerjes së heroinës që do të vinte në Shqipëri.

Shtetasit Arif Çiço, Ihsan Olmez dhe Blerim Ukimeraj kishin hyrë në Shqipëri nga PKK Morinë me mjetin 04-592-BA ndërsa Mehmet Kulug kishte hyrë me mjetin tip "VÉ Polo" me targë BJ 695 ES. Këta shtetas janë akomoduar në hotelin "Relad Park" në zonën e Kasharit dhe pagesa është kryer nga Jurgen Molla. Më datë 15.03.2016, Arif Çiço, Ihsan Olmez, Blerim Ukimeraj dhe Mehmet Kulug janë kthyer në Kosovë.



SEKRET

Më datë 17.03.2016, shtetasit Arif Çiço dhe Mehmet Kulug kanë dërguar një lidhjen e tyre, shtetasin Ekrem Hoti në Turqi, për të garantuar nisjen e ngarkesës të lëndës narkotike në kamion si dhe nisjen e tij (kamionit) për në Kosovë.

Më datë 19.03.2016, shtetasi Ekrem Hoti është kthyer në Kosovë, ku është shprehur se ngarkesa vjen të nesërmen dhe të hënën zhdoganohet.

Më datë 21.03.2016, shtetasi Blerim Ukimeraj së bashku me Ekrem Hotin janë nisur për në Shqipëri me mjetin 04-592-BA. Këta shoqëronin mjetin tip benz me targë 07-904-AQ. Ndërsa nga ana tjetër shtetasi Jurgen Molla është takuar me shtetasin Anesti Koromani 0699868319, të cilit i ka dhënë numrin 0692411116, për të komunikuar.

Mbas informacionin të përftuar në kohë reale në autostradën Fushë Krujë Vorë tek një karburant Alpet, nga ana e grupeve të vëzhgimit janë konstatuar shtetasit dhe mjetet e mësipërme dhe nga mjeti tip benz me targë 07-904-AQ është vënë re se është nxjerrë një kuti kartoni në dukje e rëndë të cilën e ka marrë shtetasi që rezultoi të ishte Romeo Beqa dhe e ka vendosur në mjetin tip "Benz Mercedes" me targë AA 221 IS, i cili drejtohej nga Anesti Koromani. Menjëherë janë njoftuar autoritetet policore të DVP Tiranë. Nga ana e tyre është bërë ndalimi i mjetit tip "Benz Mercedes" me targë AA 221 IS, i cili drejtohej nga Anesti Koromani dhe ishte i shoqëruar nga shtetasi shqiptar Romeo Beqa.

Nga kontrolli i ushtruar në mjetin AA 221 IS, u gjet sasia prej 560 gramë, e dyshuar si lëndë narkotike e llojit heroinë. Ndërsa nga kontrolli i ushtruar në banesën e shtetasit Romeo Beqa, i cili ishte në mjetin AA221IS bashkë me Anesti Koromanin u gjet një sasi prej 508 gr lëndë narkotike e dyshuar si heroinë.

*Në këtë rast janë të përfshirë shtetasit Anest Koromani, Romeo Beqaj si blerës të lëndës narkotike. Shtetasi Jurgen Molla si organizator i trafikimit të lëndës narkotike ndërsa shtetasit Arif Çiço si basjkëpunëtor i shtetasit Jurgen Molla duke bërë të kontaktojnë shtetasit Blerim Ukimeraj dhe Ekrem Hoti si shoqërues të mjetit me targë 07-904-AQ me të cilën shtetasi Elmi Thaçi ka transportuar lëndën narkotike.*

Materialet janë referuar pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Tiranë për verpën penale të "Prodhim e Shitje të narkotikëve" parashikuar nga neni 283/2 I Kodit penal.



Nga ndjekja e veprimtarisë antiligjore të këtij rrjeti kriminal, përveç aktivitetit të trafikut të lëndëve narkotike, ka rezultuar se pjesëtarë e tij janë përfshirë edhe në veprime korruptive duke ofruar shuma të konsiderueshme parash individëve në sistemin e drejtësisë.

Konkretisht drejtues të këtij rrjeti kriminal dhe pjesëtarë më të ulët të tij, kanë tentuar të korruptojnë prokurorë dhe gjyqtarë, në këmbim të lirimit të pjesëtarëve të arrestuar apo të dënuar.

Në këtë drejtim nga ana jonë janë evidentuar rastet si më poshtë vijon:

#### Rasti i parë:

Nga ndjekja në dinamikë e këtij procedimi penal, më datë 12.06.2015, ora 15.30, specialistët e Sektorit për Narkotikët në bashkëpunim me specilaistët e Drejtorisë së Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale dhe specilaistët e D.P.Q Vlorë bënë të mundur arrestimin në flagrancë të shtetasve

Robert Petoshati i biri i Xhelo dhe i Sade, lindur më 02.12.1962, banues në Vlorë, Shtetasi Robert Petoshati ishte me profesion shofer në Gjykatën e Apelit Vlorë.

Gjolek Xhaferi, i biri i Qemal dhe i Pashako, lindur më 25.02.1971, banues në fshatin Kalivaç Tepelenë.

Myqerem Çela i biri i Ago dhe i Shahe, lindur më 11.07.1954, banues në Vlorë.

Me cilësinë e provës materiale u bllokuan 20.000 euro, 207.200 lekë e aparate celularë. Shtetasi Gjolek Xhaferi me ndërmjetësimin e shtetasit Myqerem Çela kishte hyrë në bisedime me shtetasin Robert Petoshati i cili është shofer në Gjykatën e Apelit Vlorë. Synimi i Gjolekut ishte se duke paguar një sasi të konsiderueshme lekësh të ndikonte në vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë për vëllain e tij shtetasin Selam Xhaferi. Shtetasi Selam Xhaferi është dënuar me vendimin penal nr.328 dt.02.12.2010 të Gjykatës Fier me 15 vjet burg, për veprën penale të "Vjedhje me armë", parashikuar nga neni 140 e 25 i Kodit Penal.

Shtetasit e sipërpërmendur u arrestuan në flagrancë, për veprën penale "Korrupsioni aktiv i gjyqtarit prokurorit dhe i funksionareve të tjerë të drejtësisë", e kryer në bashkëpunim. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë.



## 1. Rasti i dytë:

Sqarojmë se në fillim të vitit 2015, Policia e Shtetit për llogari të drejtësisë italiane, ka arrestuar me qëllim ekstradimitin për në Itali, shtetasin Armando Gorezi, i dënuar në Itali me burgim të përjetshëm, për veprat penale, vrasje, trafik lëndësh narkotike dhe shfrytëzim prostitucioni.

Nga të dhenat e përfutuara nga puna operative gjurmuese dyshohet se fillimisht Jurgeni në koordinim me shtetasin Alket Gorezin (vëllai i Armandit), kanë financuar shuma në Euro për të manipuluar procesin e ekstradimitit, nëpërmjet korrupsionit të Prokurorit të çështjes Julian Xhengo.

Gjithashtu Jurgen Molla nëpërmjet lidhjeve në sistemin e burgjeve ka realizuar takime jashtë radhe me Armando Gorezin në burgun e Fushë Krujës, kalimin e tij për disa kohë në Spitalin e Burgut, pajisjen e tij gjatë gjithë kohës me telefon celular për të komunikuar për koordinimin e veprimeve me familjarët dhe Jurgen Mollën.

Në funksion të pengimit të ekstradimitit të Armandos, Jurgeni përveç kontakteve të vazhdueshme me vëllain e Armandos, Alket Gorezin, se ka realizuar kontakte fizike dhe me prokurorin Julian Xhengo, i cili dyshohet se fillimisht kishte marrë përsipër zgjidhjen e çështjes.

Përsa sipër po pasqyrojmë të dhëna të përfutuara nga puna operative gjurmuese zhvilluar ndaj shtetasit Jurgen Molla:

Më datë 27.03.2015, shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 0696999935 e merr shtetasi Armand Gorezi me nr. 44207052, të cilit i tregon se ka biseduar me një person të tretë, i cili i ka thënë se tani që ka ardhur dosja e Mandit e ka më të lehtë. Jurgeni i thotë të mos mërzhitet se ka për të dalë që aty.

Më datë 10.04.2015, shtetasin Jurgen Molla në numrin e telefonit 0696999935 e merr shtetasi Armand Gorezi me nr.44207052, të cilit i thotë se do të takohet vetë me prokurorin, i thotë se do ti japin ndonjë "kafe" atij. Miri i thotë se kur do e lenë, por do të flasim përsëri nesër.

Më datë 11.04.2015, shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 0696999935 e merr Mandi (Armand Gorezi) me nr.44207052, ku Mandi i thotë se nesër vjen prokurori se kishte qenë në Sarandë për punët e veta. Mandi e pyet se nëse do të bëhet ndonjë gjë apo jo. Jurgeni i thotë se do të bëhet, se për ndryshe të kishin bërë gjyçin dhe të kishin nisur. Mandi i thotë se çfarë nuk po dëgjoj këtu, se disa çuna këtu i kanë mbajtur si puna ime dhe papritur e kanë parë veten andej. Jurgeni i thotë se nuk ja merr mendja se e bën atë punë, nesër do të takohemi me atë ne. Mandi e pyet se avokati do e takojë vetë. Jurgeni i thotë, po janë shokë bashkë.

Më datë 14.04.2015, shtetasin Jurgen Molla në numrin e telefonit 0696999935 e merr Mandi (Armand Gorezi) me nr.44207052, i cili i thotë së sot kishte takim me familjarët. Mandi e pyet Jurgenin nëse e ka takuar avokatin. Jurgeni i thotë se nuk e ka takuar akoma se avokati kishte gjyq, por do të takohen patjetër me prokurorin. Mandi i thotë ta mbyllin sot muhabetin se po ikin ditët. Mandi do ta mari përsëri më vonë.

Shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 0692063800, i dërgon sms Ardianit në numrin e telefonit 0692090423 me tekst: "Si ja kalove avokat, do e takojmë atë Julin."

Më datë 15.04.2015, shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 0692063800, merr shtetasin që thërritet Arben Prenga në numrin e telefonit 0694041303, të cilin e pyet nëse di gjë nga është Visha (Avokat) dhe Beni i thotë se nuk ka komunikuar me të. Jurgeni e pyet nëse e ka takuar Julin, Beni i thotë se e ka takuar dhe kanë lënë takim për sot, për të mbaruar punë. Nuk kanë lënë orë takimi por po pret telefonatën e Julit.

Më datë 20.04.2015, shtetasin Jurgen Molla në numrin e telefonit 0696999935 e merr Mandi (Armand Gorezi) me nr.44207052, të cilit Jurgeni i thotë se do kryejnë disa veprime për në Gjykatën e Apelit. Sot e kemi lënë me Julin (prokuror) dhe me avokatin.


Më datë 21.04.2015, shtetasin Jurgen Molla në numrin e telefonit 0696999935 e merr Mandi (Armand Gorezi) me nr.44207052, të cilit Jurgeni i thotë se nuk kanë bërë gjë mbrëmë dhe se shpresojnë të mbarojnë punë sot. Mandi është i mërzhitur, se mos mbetet në burg. Jurgeni është i sigurtë se do të lirohet.

Më datë 13.05.2015, shtetasin Jurgen Molla në numrin e telefonit 0696999935 e merr Mandi (Armand Gorezi) me nr.44207052, të cilit Jurgeni i thotë se po pret që të marri letër që të shkojë ta takojë dhe e pyet që të interesohet që ta transferojnë Mandin tek Spitali i Burgut në Tiranë. Mandi i thotë se është dakort.

Më datë 28.05.2015, Jurgeni me numrin e telefonit 0692063800, merr Arben Prengën (avokat) me nr. 0694041303, të cilin e pyet se si e ka mbiemrin Juli dhe Arbeni i thotë se ai e ka mbiemrin Xhengo. Jurgeni i kërkon që t'i nisë edhe numrin e telefonit. Arbeni ja nis numrin: 0694111196. Arbeni i thotë të mos tregojë që ja ka dhënë ai numrin.

Më datë 30.05.2015, Jurgenin në numrin e telefonit 0696999935 e merr Mandi (Armand Gorezi) me nr. 0699119663, të cilit i tregon se gjërat janë vënë në vijë. Jurgeni i thotë se dje në takim ishte prezent edhe ai personi që ishte fut për Mandin, shton se janë ndarë edhe pazaret.

Më datë 01.06.2015, Jurgenin në numrin e telefonit 0696999935 e merr Mandi (Armand Gorezi) me nr. e telefonit 0699119663, i cili e pyet Jurgenin nëse ja ka mbyllur çështjen apo çështja do të shtyhet përsëri. Jurgeni i tregon se herën e





SEKRET

fundit që ka bërë takim me ata, kanë rënë dakord për pazarin dhe ato i kanë dhënë fjalën se puna ka mbaruar. Kur ka takuar vetëm atë (nuk përcakton se kë), ai i ka thënë që do të pushohet çështja andej dhe Mandi do marrë dënim një vjeçar këtu në Shqipëri. Jurgeni i thotë se dhe ajo Ilirjana e ka marrë përsipër që të lirojë Mandin.

Shtetasin Jurgjen Molla në numrin e telefonit 0696999935 e merr Mandi (Armandi) me numrin e telefonit 0699119663, ku Jurgeni i thotë se ka mbaruar punë me të tretin, shpreson tu ecë mbarë, do takohen nesër. Më vonë bisedojnë përsëri. Mandi i thotë se është takuar me avokaten, e cila i ka dhënë siguri për nesër. Jurgeni i thotë se avokatja do të merrte garanci nga personi që i ka thënë se do të flasë me atë "të madhin". Jurgeni nuk është në dijeni të kësaj pjese, nuk e di kë ka takuar avokatja. Jurgeni i thotë se pjesën e tij e ka mbaruar, i thotë se i ka dorëzuar personalisht.


Bisedojnë më vonë, ku Mandi i thotë Jurgjenit, se e ka njoftuar avokatja se nuk bëhet gjë për nesër, se duhet të presë dy javë. Jurgeni është i sigurtë se avokatja nuk ka mbaruar punë me lidhjen e saj. Mandi nuk do të paraqitet nesër në gjyq, do të marrë raport.

Më datë 03.06.2015, shtetasi Jurgjen Molla me numrin e telefonit 0696999935 merr Mandin (Armand Gorezi) që përdor numrin e telefonit 0692346218, i cili është i mërzhitur, njerëzit e tij janë takuar me të tretët, të cilët nuk ju kanë dhënë siguri. Jurgeni çuditet, se ata kanë marrë shumë. Mandi i kërkon mos t'ia bëjë letrat e dyqanit Anës (e dashura e Mandit). Mandi i thotë se mund t'i ndryshojnë, por Jurgeni i thotë se janë veprimet me Bankë. Mandi i kërkon t'ia zvarrisë punën e letrave, mos t'ia bëjë veprimet pa i thënë.

Më datë 10.06.2015, shtetasin Jurgjen Molla në numrin e telefonit 0696999935 e merr Juli me nr. e telefonit 0697321734, i cili është kunati i Armand Gorezit. Jurgeni i tregon se është takuar me Julin (prokurorin) dhe me avokaten, Juli e ka pyetur a ka mbaruar punë me "Kurtin", avokatja i ka thënë se ka mbaruar, ndërsa Juli ja ka mohuar, pasi Kurti i ka thënë ti bëj letrat. Jurgeni i kërkon të takohet me avokaten, Jurgeni mendon se nuk ka mbaruar asnjë punë, mendon se nuk ka mbaruar punë as me të madhin. Të dy janë të mendimit se avokatja po luan me ta. Avokatja i ka thënë se është regjistruar çështja, ndërsa Jurgeni i thotë se nuk qëndron pasi Mandi ka dalë në gjyq. Juli i thotë se avokatja ja hedh fajin avokatit.

Më pas shtetasin Jurgjen Molla në numrin e telefonit 0696999935 e merr Alket Gorezi, (vëllai i Armand Gorezit) me numrin e telefonit 0694899127, të cilët bisedojnë për të takuar një person së bashku për problemin e Armandos.

Shtetasi Jurgjen Molla me numrin e telefonit 0696999935, merr Tanin në numrin e telefonit 0692072502, të cilit i tregon se sapo është ndarë nga ata. Jurgeni i tregon



SEKRET

SEKRET

se femra i ka gënijer dhe i ka mashtruar dhe se ja ka marrë femrës në fjalë lekët mbrapsht si dhe ka takuar një person tjetër, i cili mund t'i gjejë ndonjë lidhje personit që u intereson.

-Në orën 22:<sup>32</sup> shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 0699921623 merr Armand Gorezin në numrin e telefonit 0692346218, të cilit Jurgeni i thotë se, ajo ka dalë bluf totalisht. I ktheu një pjesë të lekëve, ja morëm. Tani e mbrapa do të merrem me gjithë Ketin, që kush ti marrë, ti marrë vetëm prej dorës time.... Më pas Jurgeni i thotë Mandit që ta dëgjojë me kujdes, ...lidhu me shokët brenda dhe të gjesh patjetër nja dy cigare hashash. Një cigare do të dalësh ta pish në korridor para kamerave. Tjetrën do ta fusësh nën jastëkun tënd, që të vijë për kontroll dhe të ta gjejnë, që të fillojë çështja dhe të ti çojnë letrat në Krujë. Këto gjëra i ka thënë ai i madhi. Dhe sa më pak me fol dhe më saktëso se i gjen ato aty brenda. Më kthe përgjigje shpejt.

Më pas Armandi i telefonon Jurgenin dhe i thotë se do e rregullojë nesër. Jurgeni i thotë se duhet të bëhet e madhe, të dalë ta pijë në korridor. I thotë se do i dërgojë dhe Julin nesër që t'ia shpjegojë tamam. Tani nesër rri i qetë ,se do të çojë Julin se çfarë të bësh. Them se do ti rregullojmë 100%.

Më datë 11.06.2015, shtetasin Jurgen Molla në numrin e telefonit 0696999935 e merr i vëllai, shtetasi Dritan Molla me numrin e telefonit 0692072502, të cilit i thotë se është duke pritur të takohet me prokurorin.

Nga ora 12:<sup>18</sup> deri në orën 16:<sup>09</sup>, shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 0692063800, i dërgon disa sms prokurorit që dyshohet të jetë Julian Xhengo në numrin e telefonit 0694111196 dhe në numrin e telefonit 0672020197 me tekstet si më poshtë :

0694111196: "Mirdita."

0694111196: "Këtu jam unë."

0694111196: "O vëlla si të kam."


0694111196: "O vëlla un jam duke të prit te gjykata te krimet e rënda."

0672020197: "Miri jam vëlla, ku të tak se jam që në 11 duke prit."

0694111196: "O vëlla më kthe një përgjigje kur do tak se ngela këtu."

0672020197: "O vëlla më kthe një përgjigje kur do tak se ngela këtu."

-Në orën 17:24, Jurgenin e merr një shtetase femër me numrin e telefonit 0699407969, të cilës i thotë se, po pret të takohet me Julin (dyshohet prokurorin), se sot do ta takojë patjetër se i ka dhënë lekët. Personi femër i tregon se Mandin e



SEKRET

kanë sjellë në Tiranë te 302-shi, kanë frikë se mos e ekstradojnë që nesër. Jurgeni shprehet: "Ishallah nuk e ka lënë mendja e kokës Julin, ne ishim bashkë". Personi femër ka frikë se mos është me Ilirjanën, mendon se ka gisht kjo meqë i kanë marr lekët. Kësaj i bën përshtypje fakti që nuk i përgjigjet Juli. Jurgeni nuk e beson se Juli ja bën këtë lojë. Personi femër, e pyet për personin tjetër. Jurgeni i thotë se e mori përsipër Juli, do të pres një orë e gjysëm, më pas do ti shkoj në shtëpi.

Më vonë shtetasi Jurgen Molla i dërgon disa thirrje numrit të telefonit 0694111196 dhe një sms tek nr. 0672020197 me tekst: "O vëlla takohemi në mëngjes, po amanet mos më nxjerr të pa burrë."

Më datë 12.06.2015, në orën 08:32, shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 0692063800, i dërgon 2 sms prokurorit prokurorit Julian Xhengo në nr.694111196 dhe në nr. 672020197 me tekst të njëjtë si më poshtë :

0694111196: "O vëlla, ti dhe s' do me më taku, po burri e kthe një përgjigje. Dua të më takosh se s' bën. Unë do të vij të kërkoj nga të jesh vëlla."

0672020197: "O vëlla, ti dhe s' do me më taku, po burri e kthe një përgjigje. Dua të më takosh se s' bën. Unë do të vij të kërkoj nga të jesh vëlla."

-Në ora 12:58, shettasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 0692063800, i dërgon 2 sms prokurorit Julian Xhengo në nr.694111196 dhe në nr. 672020197 me tekst të njëjtë si më poshtë :

Drejt numrit të telefonit 0694111196: "Flm o shok, në besë s' ta pata borxh me më pre, po dhe po s' më takove ti do të takoj unë. Me respekt M. Molla."

## 2. Rasti i tretë:

Nga puna operativo gjurmuese në ngarkim të shtetasit Jurgen Molla, janë ngritur dyshime serioze se ky i fundit ka ofruar e financuar vlera monetare në këmbim të lehtësimit të dënimit të lidhjes së tij, shtetasit shqiptar Arben Prendi, i biri i Ndue e Tringë (Katerina), i datëlindjes 11.01.1972, lindur në Fushë-Arrëz, banues në Lezhë, i cili është në pritje të marrjes së dënimit, i arrestuar më datë 29.06.2015 duke trafikuar e transportuar nga Kosova në Shqipëri 15,420 kg heroinë për llogari të grupit kriminal.

Në funksion të këtij qëllimi, shtetasi Jurgen Molla dyshohet se duke ofruar një shumë prej 100 mijë euro, ka arritur të korrtojë prokuroren e çështjes penale në ngarkim të Arben Prendit dhe gjyqtarët që drejtojnë procesin gjyqësor në Gjykatën e Apelit të Krimeve të Rënda, respektivisht për kërkesë dhe për pranim të gjyqimit të shkurtuar për të pandehurin në fjalë. Referuar të dhënave të përgjimit të komunikimeve elektronike, për realizimin e këtij veprimi



korruptiv, rezulton se ndërmjetës në mes palëve ka qenë përdoruesi i nr. tel. cel. 00355694434473.

Dyshohet se duke qenë se gjykimi i shkurtuar bën që i pandehuri të lehtësohet automatikisht nga 1/3 e dënimit dhe të ndërpriten hetime të mëtejshme ndaj çështjes, qëllimi kryesor i shtetasit Jurgen Molla është shmangia e hetimit ndaj përfshirjes së tij si financues/organizator i rastit të trafikimit të 15,420 kg heroinë.

Po kështu dyshohet se një pjesë e shumës së parave të cituara më lart, është dhënë si mitë nga shtetasi Jurgen Molla edhe për shmangien dhe largimin e prokurorit nga ndjekja e hetimi i çështjes për operacionin ndërkombëtar "Ballkan 2014". Prokuror i saj në Prokurorinë e Krimeve të Rënda ka qenë z. Anton Martini, i cili në dhjetor 2015, me dekret të Presidentit të Republikës, është transferuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Me ndjekjen e çështjes, së fundmi është ngarkuar z. Eugen Beci, prokuror pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda.

Sqarim: Me qëllim ruajtjen e procesit penal nga dekonspirimi, kjo për shkak të lidhjeve të forta të shtetasit Jurgen Molla, pas arrestimit në qershor 2015 të Arben Prendit, nga PKR u vendos që kjo çështje të ndiqej e veçuar në dukje nga procesi penal që lidhet me operacionin ndërkombëtar "Ballkan 2014". Në këtë mënyrë do të evitohet që grupi kriminal dhe shtetasi Jurgen Molla të mësonin se tashmë veprimtaria e tyre kriminale ishte objekt i punës së policisë dhe prokurorisë.

Por, siç u tha edhe më lart, referuar të dhënave të përgjimit, ekzistojnë dyshime të forta që shtetasi Jurgen Molla tashmë është në dijeni se hetimi në ngarkim të të arrestuarit Arben Prendi, zyrtarisht lidhet edhe me një hetim tjetër të filluar më parë nga Prokuroria e Krimeve të Rënda në ngarkim të tij dhe grupit në të cilin vepron.

**Të dhëna të përftuara nga puna operative gjurmuese në ngarkim të shtetasit Jurgen Molla është si vijon:**

Më datë 07.10.2015 në orën 11:20 shtetasi Jurgen Molla kontaktohet nga shtetasja Tringa Prendi e bija Gjelosh e Dile, e datëlindjes 07.03.1954, lindur në Fushë-Arrëz, banuese në Lezhë. (Katerina), e ëma e të arrestuarit Arben Prendi, përdoruese e nr. tel. cel. 00393393523694, ndërmjet të cilëve është zhvilluar kjo bisedë:

- Tringa: Si janë punët?
- Jurgeri: Me 15 me dal në gjyc. Ne kemi kërkuar gjykim të shkurtuar, na ka ngel pa kap gjyqtarja që është caktuar. Punët janë mirë. Puna është të marrim dënimin shpejt se në dhjetor ka amnisti, rrezik mbyllet në Janar me dalë.
- Tringa: Do Zoti.



- Jurgeni: Pjesën tjetër kam mbaru unë punë, me lekë me të gjitha.
- Tringa: Të lumtë.
- Jurgeni: Nuk t'i them dot në telefon.
- Tringa: Jo, mos fol shumë.
- Jurgeni: Tani ka mbetur gjyqtarja të na pranojë gjykimin e shkurtuar, duhet me i dhënë diçka atyre me pranë.
- Tringa: E di, e di.
- Jurgeni: I kemi fut njerëzit me taku, mirë duket puna. Vetëm ti porosite atë të mos na përzihet nusja e vet.
- Tringa: I kam thënë, e kam porosit edhe nusen.
- Jurgeni: Thuaji unë nuk të pres në besë.
- Tringa: E di, ia kam thënë fjalët e tua.
- Jurgeni: Ta kam thënë edhe atë ditë, deri në atë pikë ku mundem ta çoj unë, do ta çoj. Ku nuk mundem, do i them avokatit, deri këtu kam ardhur.

Më datë 12.10.2015 Në orën 09:<sup>36</sup> shettasi Jurgen Molla kontakton përdoruesin e nr. tel. cel. 00355694434473, ndërmjet të cilëve është zhvilluar kjo bisedë:

- Personi: Erdha deri në Kukës e po kthehem poshtë. Nuk ka ndonjë gjë, thjesht për atë llafazanin. Kanë thirr atë tjetrin në vend tjetër. A kupton?
- Jurgeni: Ou?!
- Personi: Kur të vij ta shpjegoj.
- Jurgeni: Po për mua, nuk ka ndonjë ashtu?
- Personi: Për nja dy ditë ma qetëson situatën, e më tregon, si, qysh, tek.

Më datë 22.10.2015 në orën 15:<sup>48</sup> Jurgen Molla kontakton Emiljan Kroiin, përdorues i nr. tel. cel. 0035568551111, ndërmjet të cilëve është zhvilluar kjo bisedë:

- Jurgeni: Kam dy ditë që po mundohem të gjej një gjyqtar. Thashë të mbaroj punë, të ulet, të marrë gjykim të shkurtuar dhe të mbarojë punë. Nuk shtyhet kështu.
- Emiljani: Nuk është punë ajo.
- Jurgeni: Nuk shtyhet, se nuk mund të bësh asnjë punë, veç te shtëpia, te puna. Njerëzve po nuk u shkove nga mbrapa... po ishalla të shtunën, t'i jap do lekë, që t'i japin gjykim të shkurtuar dhe të mbarojë punë. Të paktën të rrij i lirë, nuk rri më në siklet.

Më datë 23.10.2015, në orën 11:<sup>41</sup> shettasi Jurgen Molla kontaktohet nga shettasi përdorues i nr. tel. cel. 00355694434473, ndërmjet të cilëve është zhvilluar kjo bisedë:



- Personi: Më thirri ai shoku me taku atë robin, duhet me i marr ato letrat me vete.
- Jurgeni: Po mo, ku je ti?
- Personi: Te Sofra e Ariut. Ato janë tre herë tre baraz nëntë. Një duhet me ia lënë atij që ka ndërmjetësu. Nuk na ka thënë gjë, po me ia lënë vetë.
- Jurgeni: Mirë, po t'i bëj gati unë tani dhe po të them, shko merri të Zogu i Zi.
- Personi: Ok, vetëm mos u vono.
- Jurgeni: A t'i them Tanit t'i sjellë atje.
- Personi: T'i sjellë më mirë te treni, se duhet t'i marr para se të takohem me të.
- Jurgeni: Ja t'i them Tanit.

Në orën 14:<sup>55</sup>, shtetasi Jurgen Molla i dërgon SMS përdoruesit të nr. tel. cel. 00355694434473, me tekst: "Mirë vëlla?", i cili i përgjigjet në orën 14:<sup>57</sup>, me sms me tekst: "Mirë, në darkë e konfirmoj". Dyshohet se shprehja "...Ato janë tre herë tre baraz nëntë. Një duhet me ia lënë atij që ka ndërmjetësu...", lidhet me sasinë e parave që shtetasi Jurgen Molla ka dhënë si mitë me ndërmjetësinë e përdoruesit të nr. tel. cel. 00355694434473, me qëllim realizimin e gjykimit të shkurtuar në favor të të pandehurit Arben Prendi. Në vlerësimin tonë shuma e parave është ndarë nga 30 mijë euro për tre persona dhe dhjetë mijë euro për "sekserin".

Më datë 05.11.2015 në orën 10:<sup>07</sup>, shtetasi Jurgen Molla kontakton përdoruesin e nr. tel. cel. 0694434473, i cili është në Gjykatë, pasi ka një gjyq. Jurgeri e pyet, nëse është gjyqi i atij shokut, dhe personi pohon. Jurgeni i kërkon, që ta telefonojë më vonë.

Më datë 16.11.2015 Në orën 20:<sup>10</sup> Jurgen Molla kontaktohet nga Tringa ose (Katerina) Prendi, përdoruese e nr. tel. cel. 00393393523694, ndërmjet të cilëve është zhvilluar kjo bisedë:

- Tringa: Më ka marrë në telefon ai shoku edhe më tha, thuaji atij shokut tim se çfarë je duke bërë për mu, se unë jam duke mbetur këtu.
- Jurgeni: Ore thuaji, që nuk ka për të mbet aty, por nuk bëhen gjërat me buton.
- Tringa: Më tha, sido që të jetë puna më trego, që të paktën të eci në krah tjetër.
- Jurgeni: Katerinë, nuk ka nevojë me ec me kërkënd në botë.
- Tringa: Unë i thashë, vetëm mbylli gojën gruas, se nuk ka punë gruaja.
- Jurgeni: Thuaji me kërkënd. Vetëm thuaji të mos na përziejë me këto telefona, se na ka kap tmerri me hap telefonin.
- Tringa: Nuk ke faj.
- Jurgeni: Thuaji, çfarë të kesh nis ato çunat të vijnë të më takojnë. Thuaji të mos flasë edhe me ty, se ata e kanë në kasetë.
- Tringa: Jo, jo nuk thamë emër ne.




- Jurgeni: Nuk ka gjë, por ta dijë, që të mos rrijë në siklet, se po e bëjmë si për vete. Ajo mund të shkojë edhe 3 ose 4 katër gjyqe, sa të shkëputemi nga gjyqet. Do merret një masë dënimi këtu, që normalisht do e marrim sa më të ulët.
- Tringa: Po, po.
- Jurgeni: Normalisht atë shoqen tjetër e kemi me vete, që ke qenë edhe ti prezent. Pastaj do e çojmë prapë në Apel, se atje krijohen më lehtësira. Thuaji vetëm t'ia mbylli gojën asaj. Unë të kam thënë, deri atje ku shkoj vetë, shkoj vetë, nuk ka nevojë me më çuar fjalë ai.
- Tringa: Po po ai nuk më merr mua në telefon, merr tjetër kund.
- Jurgeni: Mirë, thuaji që nuk e pret kush në besë. Të mos bëjë telefonata me askënd. Siç na prishe punë, thuaji, me gjykimin e shkurtuar.
- Tringa: Po, po.
- Jurgeni: Ka nejt tu fol për Sandrin.
- Tringa: Po pse nuk ia kallzojnë avokatët atij?
- Jurgeni: Po ia kanë thënë, po ai nuk do me i marrë vesh.

Më pas Jurgeni i thotë Tringës (Katerinës) se nusja e Arbenit i ka prishur shumë punë, se ka përmendur Sandrin në telefon dhe janë dorëzuar gjyqtarët në momentin e fundit. Jurgeni i thotë, se për këtë arsye ka shkuar edhe Sandri në procedim penal. Jurgeni i sqaron, se edhe "ata" e duan lekun, por nuk duan të kenë probleme. Tringa (Katerina) i thotë se ka shumë besim te ai (Jurgeni). Jurgeni i thotë se: "...kur të mos çajë dot më, do e njoftojë. Mos me pas marrë gjë ajo prokurorja, nuk i plas për kërkënd. Ju keni qenë vetë prezent, se çfarë ka bërë ajo atë ditë për ju...". Tringa pohon. Jurgeni vijon duke thënë: "...Atë ditë, iu ka çuar lekët të tre gjyqtarëve dhe në momentin para se me hy në gjyq, iu është bërë telefon nga Sandri, miku juaj, dhe është tërheq kjo kryesorja, po nuk dua të jap emra. Kur të shkojë puna për në finale që jepet vendimi, një seancë para ata thonë, që në seancën tjetër jepet dënimi. Aty duhet me shku "me u fal" te burrat e huaj, se më parë nuk kërkon gjë...". Tringa pohon përsëri. Jurgeni vijon duke shpjeguar: "...Pastaj merret masa e dënimit, se shquyr këtë anën e prokurorisë e kemi tonën... Kjo do kërkojë minimumin. Edhe me këto që japin masën, ne i kemi lidhjet. Pastaj do të shkojë në Gjykatën e Apelit, atje lehtësohet më shumë punë. Nëse këto japin 4 ose 5, ata japin 2 edhe del jashtë.... Unë këto fjalë ia kam çuar me zotërinë atje brenda. Ajo tjetra shkon dhe ndez në takim. Unë atij nuk mund t'i them atje brenda, se kujt i kam dhënë lekë dhe kujt jo... Gjyqtarët kanë ndërruar mendje në moment të fundit, madje akoma nuk kanë kthyer lekët që i ka dhënë...". Katerina është shprehur se mendon që avokatët janë shumë pasivë dhe Jurgeni i sqaron se avokatët në Shqipëri janë formalë, pasi rol luan vetëm leku.

Më datë 23.11.2015 Në orën 16:37 shtetasi Jurgen Molla kontaktohet nga Tringa (Katerina) Prendi që përdor numrin e telefonit 00393393523694, e cila i thotë se ai ka biseduar me të motrën dhe është shprehur se ka humbur shpresat. Jurgeni i thotë se ai nuk pse të humbasë shpresat dhe i sqaron që të nesërmen është një seancë tjetër, ku do të merren në pyetje personat që kanë bërë ndalimin e tij dhe do të mbahet edhe një seancë tjetër për masë dënimi. Ai (Arbeni) nuk do të paraqitet nesër në gjyq, pasi ka dhënë deklaratë. Tringa e pyet për një person nga Lezha, që i ka dalë nga telefoni dhe Jurgeni i sqaron se është një murator që rri te lokali, por që nuk ka lidhje. Tringa e pyet edhe për një person nga Shkodra, për të cilin Jurgeni i thotë se nuk e dinë kush është dhe nuk i kanë gjetur lidhje. Jurgeni i kërkon, që ajo t'i thotë Arbenit të ketë kujdes me telefonat, sidomos kur bisedon me të shoqen, pasi mund të prishen gjërat në moment të fundit. Jurgeni i thotë se kanë lidhjet, kanë lekët dhe nuk e lë brenda për lekë.

Më datë 10.12.2015, në orën 17:58 shtetasi Jurgen Molla kontaktohet nga Tringa (Katerina) Prendi me numrin e telefonit 00393393523694. Gjatë bisedës Jurgeni i përsërit disa herë se i ka vënë punët në terezi, si dhe e porosit që t'u thotë personave të tretë të mos flasin, pasi prishin punë. Tringa i ka treguar Jurgenit se e ka telefonuar i biri, Arben Prendi, personi nga burgu, i cili i ka thënë se i ka humbur shpresat dhe e ka porositur, që t'i thotë Jurgenit të mos e lërë në burg për lekë dhe se deri tani nuk është dhënë asnjë lek. Jurgeni i thotë se nuk mund t'i tregojë se ku po i jep lekët, pasi i del fjala, por i thotë se lekë janë dhënë dhe po vazhdojnë të jepen përditë. I biri i ka thënë Tringës, se po rri në burg, ngaqë nuk janë dhënë lekë. Jurgeni fajëson të shoqen e personit, e cila ka bërë pazare të mëdha. Jurgeni i përsërit, se ka dhënë lekë dhe personat që i kanë marrë, nuk e pranojnë, pasi "edhe muret kanë veshë". Tringa i betohet Jurgenit se do t'ia kthejë të gjitha lekët dhe Jurgeni e siguron se çështja do të shkojë në Apel dhe se Arbeni do të lirohet shumë shpejt.

Në vijim të kësaj bisede, Jurgeni i thotë se: "...Një që ka qenë, që ka pas prish punë aty ku është ai, një X prokuror që ka pas fut atë, e kanë shkarkuar sot. Janë dhënë lekë që është shkarkuar, nuk po të them më gjatë...". Tringa shpreh habi. Jurgeni vijon duke thënë: "...E kanë heq nga aty e kanë dërguar në Shkodër, prej këtyre punëve...". Tringa e pyet: "...E keni pas kundra atë?...". Jurgeni përgjigjet: "...Po, një legen, që e kemi pas kundër. Më gjatë nuk flas dot. Çoja me amanet, thuaji për punë lekësh...". Tringa i thotë: "...Me amanet ia çoj, faleminderit prej teje, nesër do të them çfarë më ka thënë...". Jurgeni përfundon bisedën duke i thënë: "...Thuaji, për lekë nuk rri brenda sa të jemi unë gjallë...". Dëshohet se prokurori të cilit i referohet shtetasi Jurgen Molla, është prokurori Anton Martini.





Më datë 11.12.2015 në orën 20:<sup>39</sup> shtetasi Jurgen Molla kontakton shtetasen Tringa (Katerina) Prendin, përdoruese e nr. tel. cel. 00393393523694, e cila i thotë: "...Sot kam fol me djalin dhe është shumë i revoltuar. Tha, dua me i kthy të gjitha gjyqet mbrapsht, me i fillu nga e para...". Jurgeni e pyet i habitur: "...Çfarë bo me bë?...". Tringa shprehet: "...Tha, do i grisi të gjitha letrat dhe do i kthejë gjyqet nga e para. Po pse, i thashë, se ata janë duke ec. Më tha, se nuk ka ec asgjë. Tha, nuk kam besim te askush, as te gruaja as te ti...". Jurgeni i përgjigjet: "...Ai nuk po ngel brenda, por ajo gruaja e vet merr kot. Ata avokatët kanë një zyrë dhe nuk mund t'i shkojnë sa herë që i thërret ajo në Lezhë...". Tringa i shprehet: "...Jo, jo ti s'ke faj. I thashë, thuaji gruas mos rri tu fut njerëz...". Jurgeni i përgjigjet: "...Nuk është duke ngel për këtë punë. Puna është vetëm te lekët, jo tek ata. Nesër do të të marr e të të jap një numër dhe thuaji të më marrë...".

Në orën 20:<sup>57</sup> shtetasi Jurgen Molla kontakton një shtetas që e thërret **Nandi**, përdorues i nr. tel. cel. 00355682033455 (numri figuron i regjistruar zyrtarisht në emër të shtetasit Adrian Gjura). Mes tyre zhvillohet kjo bisedë:

- Jurgeni: E mban mend atë muhabetin që më pate thënë ti? Ta kam mbyll. Për punën që pati dalë andej, për punë Kosove.
- Nandi: Po.
- Jurgeni: Ai që pati fol, që e pati mbyll, është rob i sigurt? Se kam dëgju ca fjalë të tjera sonte, më thirri dikush prandaj.
- Nandi: Po, më tha që po.
- Jurgeni: Ka marrë dikush dhe tha, kam dëgju ca llafe, tha, është duke të kërkuar filari.
- Nandi: Kur të vij unë e takojmë, se ai më tha po.
- Jurgeni: Po pra, po sonte e kishin thirr Tanin e kishin thënë kështu.
- Nandi: Sa të vij unë e takojmë.

Referuar sa më sipër, duke monitoruar lëvizjet e shtetasit Jurgen Molla dhe të lidhjeve të tij, si dhe duke analizuar të dhënat e përfuara nga përgjimi i komunikimeve elektronike në ngarkim të tij, dyshohet se rrjeti gjatë periudhës tetor - dhjetor 2015, por edhe në vijim, ka qenë duke marrë masa mbrojtëse për të shmangur kontrollin dhe penalizimin nga strukturat ligj zbatuese.

**Të dhëna informative plotësuese e sqaruese mbi pjesëtarët e këtij rrjeti kriminal:**

Shtetasi **Jurgen Molla**, alias Miri Molla, i biri Femi dhe Zamira, i datëlindjes 16.05.1978, lindur e banues në Lezhë. Aktualisht banon në Tiranë, posedon pasaportën me Nr.BC2344222. Ka përdorur numrat e telefonit celular 0696999935, 0692063800, 699809106, 0699923443, 0692630507, 0699697389, 0693575522, 0692411117, 0699921623, 0692820160, 0692887906, 0692411116,

SEKRET

0692909276, 0693365026, 0692923888 dhe 0699922225. Jurgen Molla është bashkëpronar në firmën e ndërtimit "MOLLA" shpk. Vëllezërit Jurgen e Dritan Molla janë marrë me kontrabandë naftë dhe trafik mjetesësh motorike gjatë fillimit të viteve '90, kohë e embargos së naftës ndaj ish-Federatës Jugosllave, në bashkëpunim me shtetas të tjerë.

Pas vitit 2002, vëllezërit Molla, kanë marrë ekskluzivitetin e tregtimit të "Coca-Cola" dhe birrës "Tirana" për rrethin e Lezhës, magazinat e të cilave i kanë në aksin rrugor Lezhë-Shëngjin, në vendin e quajtur "Sakë". Rreth vitit 2009 kanë filluar të merren me ndërtimin e pallateve, fillimisht në qytetin e Lezhës.

Pas vitit 2010, vëllezërit Molla janë shpërngulur në Tiranë, ku kanë filluar ndërtimin e një blloku pallatesh në zonën e Kasharit.

Shtetasi Arif Çiço, nga Prizreni, Kosovë, i datëlindjes 21.09.1976, me Dok. identifikimi nr. 1070052055 dhe nr.03858603. Ka përdorur numër. tel. cel. 0665624797, 0665526280, 0665364624, 0674732682, 0699913088, 0699811628, 0699913114, 0699210233, 0692630507, +38649865412, +38649685725 +38649754879, +905386130360.

Shtetasi Orges Myftaraj, i biri i Pëllumb e Pranvera, i datëlindjes 17.07.1986, lindur në Ballsh, banues në rrugën "Jordan Misja", Tiranë. Posedues i pasaportës me nr.BB8753322. Ka përdorur nr. tel. cel 0693206700, 0699409888, 0699410174, 0693228732.

Shtetasi Klaudio Veizaj, i biri i Pëllump e Ëngjellushe, i datëlindjes 04.12.1982, lindur në Berat e banues në Tiranë. Ka përdorur nr. tel. cel. 0699602071, 0699204219, 0699923404, 0692470277, 0693743199.

Shtetasi Enver Kurtulaj, i datëlindjes 14.09.1979, përdorues i pasaportës me nr.U03215381, figuron të jetë banues në Stamboll. Ka përdorur nr. tel. cel. 0038649877508. Përdor edhe kartë identiteti kosovare nr.ID0220789, datëlindje 14.09.1979, me gjeneralitetet Enver Alijaj.

Shtetasi Abubekir Tuncdemir, i datëlindjes 24.02.1952, lindur në Van, banues në Stamboll. Mbajtës i pasaportës me nr.U04255468. Ka përdorur nr. tel. cel. 0698712878, 0699857491, +905377445095, +381638721643, +905340333066.

Shtetasi Mehmet Kulug, shtetas turk, i datëlindjes 01.01.1964, përdorues i pasaportës U0714743, ka hyrë në Shqipëri me automjetet me targa 34JIS37 dhe EJ695VVS. Ka përdorur nr. tel. cel. 00905352647222, 00905456909409, 0033753991671.

Shtetasi Blerim Ukimeraj, shtetas kosovar i datëlindjes 08.07.1977, përdorues i pasaportës me nr.KO0085216, përdorues i nr. tel. cel. +38649754879.

Shtetasi Elmi Thaçi, i datëlindjes 15.10.1962, përdorues i kartës së identitetit kosovare me nr. ID02263419.



SEKRET

SEKRET

Shtetasi Shyqyr Kotorri, i datëlindjes 11.04.1978, i biri i Sabri e Dife, lindur e banues në Kreshovë, Përmet. Ka përdorur nr. tel. cel. 0695144403, 0695546012.

Shtetasi Ekrem Hoti, i datëlindjes 15.03.1985, shtetas kosovar, përdorues i kartës së identitetit kosovare me nr.ID0472996.

Shtetasi Arben Prendi, i biri i Ndues dhe i Tringës, i datëlindjes i datëlindjes 11.01.1972, lindur në Fushë Arrëz të rrethit Pukë dhe banues në qytetin e Lezhës, lagjja Varosh. Ka përdorur nr. tel. cel. 0699886936.

Shtetasi Anesti Koromani, i biri i Ali e Hatixhe, i datëlindjes 19.04.1981, lindur në Skrapar, e banues Tiranë. Ka përdorur nr. tel. cel. +306948315404, +306948315610, +306947633954, 0699808650, 0692351781, 0699868319.

Shtetasi Romeo Beqa, i biri i Muhedin dhe Fatmira, i datëlindjes 14.09.1982, lindur në Skrapar dhe banues Tiranë.

Shtetasi Armando Gorezi, i biri i Idajet e Fatbardhe, i datëlindjes 19.11.2016, lindur dhe banues në Kuçovë. Gjatë kohës që ishte në burg, ka përdorur nr. tel. cel. 0699119663. Në korrik 2015 është ekstraduar në Itali, pasi ishte i dënuar me burgim të përjetshëm për vrasje, trafik droge, etj.

Shtetasi Erol Belir, e datëlindjes 12.06.1990, përdoruese e pasaportës me nr.U09683837. Është arrestuar në shtator 2015 në Greqi me 5 kg heroinë.


Shtetasi Songul Erek, i datëlindjes 04.10.1971, lindur në Bakirköy dhe banues në Stamboll, përdorues i pasaportës me nr.U05128192. Është arrestuar në shtator 2015 në Greqi me 5 kg heroinë.

Shtetasi Milisav Perovic, i datëlindjes 24.06.1973, përdorues i pasaportës me nr.009655614-CS. Është arrestuar në Bullgari në shkurt 2016, pasi ishte duke transportuar një sasi 2.1 kg heroinë.

Lidhur sa parashtrova më lart, mbeshtetur ne nenet 327/1 dhe 331/2 te K.Pr.Penale:

SUGJEROJ

Dërgimin për gjykim të procedimit penal Nr. 81 te vitit 2015, në ngarkim të shtetasve Jurgen Molla, Anesti Koromani, Orges Myftaraj, -Klaudio Veizaj, Shyqyr Kotorri, Arif Çiço, Enver Kutulus, Abubekir Tuncdemir , Nuredin Nazeraaj, Luizim Qorri, Elton Nazeraaj, shtetasi Land Lleshi ose Denis Isuf Sinameta, Romeo Beqa, Blerim Ukimeraj, Ekrem Hotin, Elmi Thaçi, te akuzuar se kanë kryer veprat penale te parashikuara nga nenet 283/2, 283/a/2, ndërkohë




SEKRET

që shtetasit Jurgen Molla, Anesti Koromani, Arif Çiço, Abubekir Tuncdemir krahas neneve 283/2, 283/a/2 të akuzuar edhe për nenin 333 të K.Penal pasi ka se e kanë kryer aktivitetin kriminal në formën e një grupi të strukturuar kriminal.


Gjithashtu sugjeroj vazhdimin e verifikimeve dhe veprimeve të nevojshme për rastet e veprimeve korruptive të kostatuara gjatë këtij hetimi. Kjo për arsye të individualizimit të përgjegjësive së gjithsecilit. Për këtë duhet të bëhet zbardhja dhe dokumentimi me proces verbal i përgjimit të telekomunikimeve në rastin kur shtetasi Jurgen Molla në muajt Maj dhe Qershor, përdoruesit e numrave të telefonit 0692050065, 0699119663, 0699407969, 0672330060, etj, me shtetasit që janë konstatuar në raportet e shërbimit të datave 09, 10 dhe 11.06.2015 si dhe bashkëpunëtorë të tjerë kanë sajuar një kallzim të bërë nga punonjës të policisë së burgjeve për të bërë të mundur mosekstradimin e shtetasit Armando Idajet Gorezi i datëlindjes 19.11.1975. Për këtë rast Prokuroria e Rrethit Gjiqësor Tiranë ka vendosur mosfillimin e çështjes. Këta shtetas në bashkëpunim me njëri tjetrin ka dyshime të arsyeshme që kishin paguar para për të korruptuar zyrtarë të Prokurorisë së Rrethit Gjiqësor Tiranë për mosekstradimin e shtetasit Armando Gorezi në drejtim të Italisë. Shtetasi Armando Gorezi ishte kapur nga policia e shtetit pasi ishte shpallur në kërkim nga ZQK Interpol Tirana pasi, Gjykata Torino/ Itali kishte lëshuar urdhërin e arrestit nr.5364/12RGNR- 24320/13 RG GIP dt.06.05.2014. V.Penale "Vrasje" parashikuar nga nenet 575, 577 të K.Penal Italian. Ky shtetas ishte ndaluar me qellim ekstradimi drejt Italisë. Çështja po ndiqej nga Prokuroria e Rrethit Gjiqësor Tiranë.

Si dhe për rastin kur nga studimi i raportit të shërbimit të datës 05.11.2015 rezulton se automjeti BMË X5, me ngjyrë të zezë, me targa AA999BU është konstatuar i parkuar në pranë Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë. Tek automjeti me targa AA999BU në orën 11:30 afrohet dhe hipën një shtetas rreth 40 vjeç, me fokë të shkurtra të thinjura, veshur me këmishë me ngjyrë të bardhë, pantallona të zeza sëbashku me një shtetas tjetër rreth 35 - 40 vjeç me flokë të shkurtra, veshur me këmishë ngjyrë të bardhë, kostum gri. Automjeti ka vazhduar rrugën nga rruga Asim Vokshi, në bulevardin Zogu i I". Nga komunikimet me qëndrën e përgjimeve dhe pas studimit të raporteve të shërbimit ka dyshime të arsyeshme se shtetasi Jurgen Molla me ndërmjetësimin e dy shtetasve që hipën në mjetin me targa AA999BU, nga të cilët njëri është drejtuesi i mjetit dhe ka rolin e sekserit dhe tjetri është avokati i shtetasit Arben Prendi i



cili thërritet Arbër, po kërkonin që të korruptonion zyrtarë të Gjykatës së Shkallës së parë për Krimë të Rënda Tiranë me qëllim pranimin e gjyqimit të shkurtuar për shtetasin Arben Prendi për rastin e sekustrimit të 15 kg lëndë narkotike të llojit heroinë në P.K.K Morinë. Për këtë shtetasi Jurgen Molla me numrin e telefonit 0692411116 ka komunikuar në mënyrë të vazhdueshme me nënën e shtetasit Arben Prendi e cila përdor numrin e telefonit 00393393523694. Ku Jurgeni vazhdimisht i tregon se është duke punuar për ta ndihmuar Arben Prendin dhe është duke paguar vazhdimisht lekë për këtë gjë. Konkretisht më datë 10.12.2015, në orën 18:02:59 shtetasi Jurgen Molla kontaktohet nga Tringa (Katerina) Prendi me numrin e telefonit 00393393523694. Gjatë bisedës Jurgeni i përsërit disa herë se i ka vënë punët në terezi, si dhe e porosit që t'u thotë personave të tretë të mos flasin, pasi prishin punë. Tringa i ka treguar Jurgenit se e ka telefonuar i biri, Arben Prendi, personi nga burgu, i cili i ka thënë se i ka humbur shpresat dhe e ka porositur, që t'i thotë Jurgenit të mos e lërë në burg për lekë dhe se deri tani nuk është dhënë asnjë lek. Jurgeni i thotë se nuk mund t'i tregojë se ku po i jep lekët, pasi i del fjala, por i thotë se lekë janë dhënë dhe po vazhdojnë të jepen përditë. I biri i ka thënë Tringës, se po rri në burg, ngaqë nuk janë dhënë lekë. Jurgeni fajëson të shoqen e Arbenit, e cila ka bërë pazare të mëdha. Jurgeni i përsërit, se ka dhënë lekë dhe personat që i kanë marrë, nuk e pranojnë, pasi "edhe muret kanë veshë". Tringa i betohet Jurgenit se do t'ia kthejë të gjitha lekët dhe Jurgeni e siguron se çështja do të shkojë në Apel dhe se Arbeni do të lirchet shumë shpejt.

Në vijim të kësaj bisede, Jurgeni i thotë se: "...Një që ka qenë, që ka pas prish punë aty ku është ai, një X prokuror që ka pas fut atë, e kanë shkarkuar sot. Janë dhënë lekë që është shkarkuar, nuk po të them më gjatë<sup>3</sup>...". Tringa shpreh habi. Jurgeni vijon duke thënë: "...E kanë heq nga aty e kanë dërguar në Shkodër, prej këtyre punëve...". Tringa e pyet: "...E keni pas kundra atë?...". Jurgeni përgjigjet: "...Po, një legen, që e kemi pas kundër. Më gjatë nuk flas dot. Çoja me amanet, thuaji për punë lekësh...". Tringa i thotë: "...Me amanet ia çoj, faleminderit prej teje, nesër do të them çfarë më ka thënë...". Jurgeni përfundon bisedën duke i thënë: "...Thuaji, për lekë nuk rri brenda sa të jem unë gjallë...". Dyshohet se prokurori të cilit i referohet shtetasi Jurgen Molla, është prokurori Anton Martini.



S E K R E T

Këtë gjë ka dyshime të asyeshme se shtetasit e mësipërm nuk e kanë arritur sepse Gjykata e Shkallës së Parë për Krime Të Rënda ka vendosur që të mosë pranohet gjykimin i shkurtuar për çështjen në ngarkim të shtetasit Arben Prendi.

Në këto raste shtetasit e përfshirë ka dyshime të arsyeshme se shtetasit e sipërpërmendur janë përfshirë në veprimtarinë kriminale të Korrupsionit pasiv të gjyqtarit, prokurorit dhe të funksionarëve të tjerë të drejtësisë, parashikuar nga neni dhe Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike parashikuar nga Neni 245/1 i Kodit Penal.

Ndërkohë të gjithë shtetasit e përfshirë në këtë aktivitet të kundraligjshëm të hetohen në kuadër të Ligjit Nr.10192, datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave prarandaluese kundër pasurisë",

Oficeri i Policisë Gjyqësore  
Gjergji OSHAFI

